



**UNIVERSITETI I EJL**  
**ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ**  
**SEE UNIVERSITY**

**STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

**TEZA:**

**STRUKTURA NARRATIVE DHE GALERIA E  
PERSONAZHËVE NË PROZËN E DRITËRO AGOLLIT**

**KANDIDATJA:**  
**Mamudije Muaremi**

**MENTORI:**  
**Prof. Dr. Hamit Xhaferi**

**Tetovë, 2020**

# Përmbajtja

Hyrje.....	6
------------	---

## **KREU I:**

1.1. Letërsia bashkëkohore shqiptare.....	8
1.2. Jeta dhe veprimtaria letrare e Dritëro Agollit.....	12
1.3. Jeta.....	12
1.4. Veprimtaria letrare.....	13

## **KREU II:**

2.1. Struktura narrative dhe galeria e personazhëve.....	22
2.2. Analizë e romanit “Komisari Memo”.....	22
2.3. Galeria e personazhëve në romanin “Komisari Memo”.....	25
2.4. Analizë e romanit “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”.....	26
2.5. Galeria e personazhëve në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” .....	31

### **KREU III:**

3.1.	Analizë e romanit “Njeriu me top”.....	33
3.2.	Galeria e personazhëve në romanin “Njeriu me top”.....	37
3.3.	Analizë e romanit “Dështaku”.....	38

### **KREU IV:**

4.1.	Analizë e romanit “Arka e djallit”.....	43
4.2.	Analizë e romanit “Trëndafili në gotë”.....	46
4.3.	Përfundim.....	47
4.4.	Literatura e shfrytëzuar.....	48

**Pena e tij mbetet universale për çdo kohë dhe çdo sistem...**



## Hyrje

Të shkruash për të madhin Dritëro, është shumë pak, pasi vepra e tij madhore e voluminoze me vlera të pasura e të pakrahasueshme për të sotmen e të ardhmen e kombit tonë, është një thesar i çmuar kulturor në plejadën e shkrimtarëve modern.

**Dritëro Agolli, kolosi gjigant, gjeniu i letrave shqipe, Homeri i gjallë e i vërtetë, jo vetëm i Shqipërisë por i mbarë qytetërimit modern, që ka bërë epokë në kufinj të dy shekujve, e që i ka kënduar tërë jetën njeriut si qenia më e pasur e planetit, qytetarit modern e të civilizuar., shqiptarit, vendlindjes e shoqërisë, me të gjitha plagët e saj, e që i ka thurrur himne poetike Shqipërisë hallemadhe shekullore, si një Iliadë e ditëve tona, me vlera madhore, një vend i vogël, por me një komb të madh e në zemër të Europës.**

Një mendjendritur e trim, rrallë bashkohen këto dy cilësi tek një njeri, për të drejtën, për paqen. Poeti i historisë së Shqipërisë së shenjtë, të lashtë e etnike, të pasur e krenare për çdo kombas. Një ndër liderët e demokracisë së vjetër e të re, udhëheqësi shpirtëror i masave të ulëta e të mëdha të popullsisë që kanë bërë e bëjnë historinë e kombeve e të shteteve të planetit tokë. Prandaj jemi krenar dhe e thërrasim babai i letërsisë së re moderne, i letërsisë e i poezisë popullore, i madhi Dritëro.

**Ai është një muze i gjallë tipik i popullit shqiptar, me krijimtarinë e tij voluminoze e të pashtershme, një shqiptar i mençur, trim e paqedashës, për liri, paqe e demokraci, shembull për tërë njerzimin e sotëm e të brezave të ardhshëm. Ai është një artist i kalibrit botëror, që me gjuhën e penës, ka lëvruar të gjitha llojet e gjinitë e letërsisë, të artit të madh të popullit, njohës i thellë e realist, që kritikët më me zë e kanë vështirë ta kategorizojnë, shkrimtar apo gazetar, publicist, poet apo prozator, novelist apo romancier, komedian apo fabulist, dramaturg apo skenarist filmash që producentë më famozë sot në botë, da ta kishin zili të prodhonin filma me skenarët e tij poetik e letrarë për jetën njerëzore e realiste, e jo të fabrikuar.**

**Krijimtaria e poetit është si një ushqim i shpirtit. Ajo ka marrë vlerësimet e njerëzve të mëdhenj, liderëve e personaliteteve të letrave e të letërsisë, të kritikës e të historisë botërore. Vepra e tij, qoftë në prozë, qoftë në poezi është studiuar nga studiues**

**të ndryshëm. Në veprat e tij ai është aq i thellë,**

**qiellor dhe tokësor, njëkohësisht aq i kapshëm dhe aq i pakapshëm, në planin e leximit, sa që, çdoherë kur e lexon të bën**

**ta duash** e ta urresh, ta vërvitësh librin që ke në dorë, të lëshosh një ofshamë e të thuash, po ky është arti. Ai është shkrimtar i madh. Përveç të tjerash, këtë e dëshmon fakti i të qenit fitues i disa çmimeve dhe i nderimeve të tjera, si dhe për faktin që veprat e tij janë përkthyer në disa gjuhë të botës.

**Dritëro Agolli bashkë me bashkëkohësin e tij, Ismail Kadare janë dy kolosët më të mëdhenj të letrave shqipe, të letërsisë moderne botërore, që po bëjnë epokë në kufijtë midis dy shekujve,** të cilët meritojnë vëmendjen e interesin e Çmimit Nobel, pavarësisht se janë të dy binjakë të historisë, apo nga një vend i vogël, apo se fama e tyre zbehet nga hija e megallomaneve. **Ai mbetet një pishtar e udhërrëfyes i mendimit demokratik dhe i urtësisë popullore në të gjitha proceset**

**demokratike e ato të tranzicionit, duke qenë realist i çiltër, i guximshëm e i hapur, e largpamës për të ardhmen, një lider i paqes e i pajtimit kombëtar.**

Dritëro Agolli është shkrimtar shumë i lexuar e shumë i dashur prej lexuesve shqiptarë edhe pse është i vendosur si asnjë krijues tjetër, pse është i vendosur shumë natyrshëm dhe shumë krijueshëm, në traditën letrare dhe në përgjithësi kulturore shqiptare.

**Në krijimtarinë e tij letrare e publicistike jetojnë të shprehura artistikisht ndjeshmëria dhe mençuria popullore.**



## KREU I

### 1.1. Letërsia bashkëkohore shqiptare

Vazhdimisht kam qenë kureshtarë për letërsinë moderne. Më kujtohet, qysh heret kam bërë përpjekje të depërtoj në botën e modernes. Që nga ajo kohë e gjatë viteve në vazhdim të jetës sime, **Agolli ishte shumë i rëndë dhe shumë i madh për mua.** Kur lexoj veprat e tij më duket sikur unë kam shkuar mysafire në shtëpinë e tij dhe herë i rreptë e krenar, herë buzëgaz e mikpritës, as nuk më thotë urdhëro brenda e as nuk më nxjerr jashtë. Interesimi im për letërsinë moderne shqiptare, u bë mundësi kërkimi profesional gjatë kohës së studimeve. Aty duke debatuar, duke folur dhe përfolur për letërsinë, duke organizuar ligjeratat, formësohej çdoherë e më shumë kërkesa dhe dëshira për t'a studiuar më gjerësisht.

**Duke u marrë me këto tema, doemos edhe me veprat e Agollit, mësova për praninë e mendimit të lirë, që është karakteristikë e vlerësimit të kësaj letërsie.** Kjo do të thotë se vlerësimi për këtë letërsi, nuk duron t'i thuash tjetrit

“ti e ke gabim”, “nuk është ashtu”, ose “ti s’di gjë”, por karakteristikë e saj është “respektimi i mendimit ndryshe”. Megjithatë, të mos keqkuptohemi. Kjo nuk do të thotë që pajtohesh, thjeshtë mund të mendosh ndryshe nga tjetri për një çështje, por nuk guxon të mos kesh respekt ndaj mendimit të tjetrit. **Kjo edhe është**

**magjia e shqyrtimit të letërsisë sonë. Prandaj edhe tema ime “Struktura narrative dhe galeria e personazhëve në prozën e Dritëro Agollit”, është një përpjekje tjetër në rrjedhën e përforcimit të këtij mendimi të lirë.**

Pas Luftës së Dytë Botërore letërsia shqiptare eci në një rrugë mjaft të vështirë e komplekse. **Karakteristikë kryesore e kësaj periudhe është shkëputja jo e natyrshme e letërsisë nga tradita e saj dhe ndikimi i fuqishëm, po ashtu jo i natyrshëm, që ushtroi mbi të përvoja krijuese e metodës së realizmit socialist. Veçoria tjetër, mbase më e rëndësishme dhe me pasoja më të rënda, është se letërsia shqiptare do të zhvillohej e ndarë nga një kufi politik**

# brutal dhe kufizimet e një regjimi

## **diktatorial.** Kështu do të kemi: letërsi të zhvilluar brenda kufirit të shtetit

shqiptar; të shqiptarëve në përbërje të ish Jugosllavisë, kryesisht në Kosovë dhe në Maqedoni, si dhe të shqiptarëve të diasporës. Këto karakteristika ndikuan fuqishëm në rrjedhën e letërsisë shqiptare në përgjithësi, si dhe në fizionominë, strukturën artistike apo frymëzimin tematik të saj. Gjatë katër dhjetëvjetëshave të parë të shekullit XX e sidomos gjatë viteve '20 e '30 letërsia shqiptare pati një zhvillim të hovshëm dhe të gjithanshëm. U rrit si numri i krijuesve, ashtu dhe numri i veprave letrare të botuara, të cilat u ngritën në një shkallë më cilësore artistike, duke krijuar premisat për një komunikim më të afërt me përvojat e përgjithshme letrare në Evropë. Përmes shkrimtarëve të talentuar, të shkolluar nëpër qendra të ndryshme të Evropës, në letërsinë shqiptare filloi të depërtojë fryma e drejtiveve dhe e ndjeshmërive të reja krijuese letrare të kohës. Siç dihet, gjatë këtij harku kohor shkrimtarë të mëdhenj të letërsisë shqiptare, si: Fishta, Konica, Noli, Poradeci, Koliqi, Migjeni, Kuteli, shënuan disa nga kulmet më të larta të letërsisë shqiptare, në llojet dhe zhanret e gjinive të ndryshme. Në këtë kontekst letrar llojet e gjinisë lirike do të jenë ato që përparojnë, por një hov të dukshëm do të marrin edhe llojet epike, drama, kritika dhe teoritë letrare.

Krejt ky fluks i pasur krijuesish të talentuar të moshave të ndryshme, të nxitur dhe të mbështetur nga shtypi periodik letrar i drejtiveve dhe i shkollave të ndryshme, do të vazhdojë, thuajse po me këtë ritëm dhe gjatë pjesës së parë të viteve '40. Për çudi, jehona e hovit të tillë krijues nuk u ndërpre menjëherë pas përmbysjes së pushtimit nazist dhe vendosjes së pushtetit komunist. Pati një tolerancë gjatë ditëve të para të pushtetit të ri ndaj frymës së lirë, liberale në krijimtarinë artistike, e cila do të vazhdojë ta ketë këtë fat edhe për dy-tre vjet. Por siç dihet, tanimë nuk ishte më ai rreth individualitetesh të jashtëzakonshëm krijuesish të viteve'30. Noli e Koliqi do të vazhdojnë të krijojnë nëpër Evropë e Amerikë, por të shkëputur totalisht nga letërsia në Shqipëri dhe pa kurrfarë ndikimi mbi të. Lasgushi kishte pushuar së krijuari. Migjeni dhe Fishta nuk ishin më. Nga ky rreth kolosësh të letërsisë shqiptare, vetëm Kuteli do vazhdojë të jetë vazhdimi i natyrshëm i letërsisë së Pasluftës duke botuar sa herë i hiqej censura. Do të vazhdojnë

fare ndryshe krijimtarinë e nisur që më parë: Petro Marko, Vedat Kokona, Shefqet Musaraj, Fatmir Gjata, Sterjo Spasse, Nonda Bulka, Dhimitër Shuteriqi etj. Nga poetët që krijuan në vitet e para të çlirimit dhe që krijimtaria e tyre pati jehonën e entuziazmit kolektiv të këtyre viteve, janë: Aleks Çaçi, Luan Qafëzezi, Llazar Siliqi etj. Kështu, pas luftës dhe gjatë viteve '50 do të duket qartë orientimi i ri në fushën e letërsisë shqiptare, si në rrafshin tematik, dhe në atë të përvojave dhe të metodave e prosedeeve krijuese. Tematikisht letërsia u përqëndrua kryesisht, në jehonën e lirisë së fituar nga Lufta Nacionalçlirimtare, kurse ngjyrimi i aktualitetit dhe i botës reale u reduktua kryesisht në bardhë e zi. Si përvojë shkrimi, veprat letrare të kësaj periudhe shpesh do të qëndrojnë ndërmjet gjuhës së rrëfimit letrar dhe atij propagandistik. Kryesisht këtë vulë proceduese kanë romanet e para gjatë viteve '50. Po kaq skematik ishte dhe mendimi kritik zyrtar i asaj kohe, që do ta përkrahte këtë letërsi. Nga fundi i viteve '50, e sidomos me fillimin e viteve '60, pra pas një dekade e gjysmë që nga çlirimi, do të bëhen hapat e parë për ta nxjerrë nga ky shabllon letërsinë shqiptare.

**Në këtë kontekst duhet përmendur, pikërisht viti 1958, kur Petro Marko do të botojë romanin e tij të parë "Hasta la Vista", që sjell një tjetër tematikë në romanin shqiptar, një tjetër frymë dhe ndjeshmëri në paraqitjen e personazheve (tanët dhe të huajt).** Dy vjet më vonë ai do të botojë dhe romanin

"Qyteti i fundit" me prirje për të shmangur skematizmin.<sup>1</sup> Pas tij Ismail Kadare boton romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1962), që, shtegun e paralajmëruar nga romanet e Petro Markos, do ta ngrejë në një nivel ndërkombëtar. Pas romaneve të dy autorëve të

---

<sup>1</sup> [https://wikisource.org/wiki/Letërsia\\_Moderne](https://wikisource.org/wiki/Letërsia_Moderne)

përmendur, gjatë viteve '60, Jakov Xoxa do të botojë romanin "Lumi i vdekur" që, nga një aspekt tjetër procedura, do të konsolidojë prirjen e romaneve shqiptarë, për të kërkuar rrugë të reja në paraqitjen e botës shqiptare. Pas Jakov Xoxës **do të**

**paraqitet Dritëro Agolli me një seri romanesh,** Dhimitër Xhuvani, Ali Abdihojha, Skënder Drini, Sabri Godo,

Vath Koreshi etj., ndërsa majën e poezisë lirike do ta zenë Fatos Arapi, **Ismail**

**Kadareja dhe Dritëro Agolli, të cilët do të çelin një rrugë të mbarë dhe për një brez**

**poetësh të rinj të talentuar** si: Dhori Qiriazi, Bardhyl Londo,

Xhevahir Spahiu, Frederik Rreshpja, Natasha Lako etj. **Dritëro Agolli,**

**është një nga personalitetet më të shquara të letërsisë shqipe. Është poet, prozator,**

**publicist dhe kritik. Krijimtaria e tij letrare dhe publicistike, është shumë e pasur. Ai me**

**krijimtarinë e tij, letërsinë shqipe e ka prezantuar denjësisht në aspektin global. Pa**

dyshim është njëri prej personaliteteve më dinamike e më kreative në letërsinë tonë. Vepra e tij është e përkthyer në disa gjuhë të botës.

Dritëro Agolli me krijimtarinë e pasur thesar, krijoi traditën e re të letërsisë shqiptare. Ajo na bën të ndihemi me dinjitet përballë botës së madhe. Poeti i madh i një “gjuhe të vogël” por të artë, si është shqipja, ai është po aq i dashur prej lexuesve bashkëkombës, sa dhe në metropolet e kulturës botërore.<sup>2</sup> Dritëro Agolli s’ka pushuar së qeni një poet mjaft popullor, që s’mban kurrfarë distance me lexuesin e thjeshtë; që dhimbjen, gëzimin dhe dobësinë

---

<sup>2</sup> Grup autorësh, *Gjuha shqipe dhe Letërsia 4*, Tetovë, 2004, f. 111

njerëzore i merr si ndjenja universale dhe i shkrin me filozofinë jetësore. Dritëro Agolli, një nga zërat më të fuqishëm dhe individualë të letërsisë shqipe, mban titullin “Nderi i kombit” nga viti 1988. Vepra e tij letrare është përkthyer në shumë vende të botës si Francë, Gjermani, Itali, Rusi, Greqi, Spanjë, Rumani, Portugali, Norvegji, Siri, Izrael, Danimarkë etj. Ai ka shkruar në të gjitha zhanret si në poezi, publicistikë, dramë, skenarë filmash dokumentarë dhe artistikë.

Agolli ishte fitues i katër çmimeve të Republikës dhe i disa çmimeve vjetore në letërsi. Dritëro Agolli, ishte Anëtar i Akademisë së Firences “Muzat” në Itali. Ai ka qenë Qytetar Nderi i qyteteve të Korçës, Tiranës, Gjirokastrës etj.

## 1.2. Jeta dhe veprimtaria letrare e Dritëro Agollit

### 1.3. Jeta

Dritëro Agolli lindi më 13 tetor 1931 në Menkulas të Devollit afër Korçës. Pasi mori mësimet e para në vendlindje, vazhdoi gjimnazin e Gjirokastrës, një shkollë me mjaft traditë. Studimet e larta për letërsi i mbaroi në Petërburg. Ka punuar shumë kohë gazetar në gazetën e përditshme "*Zëri i popullit*", dhe për shumë vjet ka qenë Kryetar i *Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë*. Për tridhjetë vjet me radhë Dritëro Agolli u zgjodh deputet. Në vitin 2011 Dritëro Agolli, është nderuar me titullin doktor Honoris Causa nga Universiteti Europian i Tiranës. Në një ceremoni të veçantë, iu dha ky titull shkrimtarit të shquar “Për kontributin e madh dhe të rëndësishëm në krijimtarinë e tij letrare për më shumë se 60 vjet, si poet, prozatorë, dramaturg përkthyes e eseist”.

Krijimtaria e tij letrare është mjaft e pasur në gjini e lloje të ndryshme: poezi, poema, tregime, novela, romane, drama,



skenarë filmash etj. Është fitues i disa çmimeve dhe i nderimeve të

tjera.<sup>3</sup> Disa prej veprave më të rëndësishme të tij janë përkthyer në Perëndim e në Lindje. Dritëro Agolli hyri që në fillim në letërsinë shqiptare (vitet'60) si një protagonist i saj, duke e ndryshuar përmasën e së ardhmes **Në veprën e Agollit e pa veten si protagonist**

**bujku dhe bariu, fshatari dhe studenti, malësori dhe fusharaku** **Agolli u bë**

**poeti i tokës dhe i dashurisë për të,**

**shkrimtari i filozofisë dhe i dhimbjes**

**njerëzore. Vepra letrare e Dritëro Agollit**

**krijoi traditën e re të letërsisë shqiptare. Në**

**prozën e tij Agolli solli risi jo vetëm në**

**strukturën narrative, por dhe në galerinë e**

**personazheve të veta.** Ata janë sa të çuditshëm aq dhe të

zakonshëm, sa tragjikë aq edhe komikë, sa të thjeshtë aq edhe madhështorë.

**Frazeologjia e pasur popullore dhe filozofia**

**jetësore e bëjnë përgjithësisht tërë veprën**

**letrare të Agollit sot për sot ndër më të**

**lexuarën.**

---

<sup>3</sup> Grup autorësh, *Gjuha shqipe dhe Letërsia 4*, Tetovë, 2004, f. 111

Shuhet më 3 shkurt 2017 në Tiranë në moshën 85-vjeçare kolosi i letrave shqipe, Dritëro Agolli. Shkrimtari i madh ndërroi jetë në sanatoriumin e Tiranës, ku ishte shtruar prej 9 ditësh pas një sëmundje të rëndë në mushkëri që e mundonte prej kohësh. Gjendja e tij shëndetësore ishte rënduar shumë kohët e fundit, aq sa frymëmarrja e tij realizohej nëpërmjet furnizimit artificial me oksigjen. Tre ditët e fundit mjekët ishin munduar që ai të merrte frymë vetë, por sëmundja plmonare kronike, që e mundonte prej 20 vitesh, nuk lejoi të kthehej më në shtëpi. Shkrimtari kurohej prej të paktën një viti në shtëpi duke refuzuar shtrimin në spital. Por pak ditë më parë, ai pësoi një përkeqësim të menjëhershëm që detyroi familjarët dhe mjekët ta shtronin me insistim në sanatoriumin e Tiranës, ku dhe qëndroi i shtruar 9 ditë derisa ndërroi jetë.<sup>4</sup>

**Disa pjesëza të zgjedhura nga rrëfimet e shkrimtarit të madh Dritëro Agolli, na zbulojnë pothuajse çdo skutë të panjohur të jetës së tij. Janë rrëfime intime të ngjarjeve të ndodhura brenda familjes, të cilat pas ikjes së tij nga jeta, duket se marrin një vlerë të veçantë.** Kujtimet e fundit, të lëna në dorëshkrim, që nisin që nga fëmijëria

e shkrimtarit, i zbulon vetë e bija Elona Agolli, duke na rrëfyer letrat me shkrim dore.

Dora e Dritëro Agollit nuk rreshti së shkruari deri ditën e fundit, edhe pse kishte nisur të dridhej prej gjendjes jo të mirë shëndetësore. Shkrimtari i madh, ndërroi jetë më 3 shkurt të vitit 2017, por edhe tre vjet nga mungesa e tij dorëshkrimet e panjohura na japin një shenjë të veçantë komunikimi. Hera-herës ato janë plotësimi i intervistave të pamundura, ose i fjalëve që s’e kanë gjetur kohën e duhur për t’u thënë.

---

<sup>4</sup> <https://www.teksteshqip.com/dritero-agolli/biografia>

Sot, kjo prekje magjike me dorëshkrimet ende të pabotuara të Dritëro Agollit sjell në sytë tanë disa anë të panjohura të origjinës së familjes së tij në Menkulas të Korçës. Dritëro Agolli rrëfen për ditën e lindjes së tij, e cila është e pamundur të shkëputet nga plagët e dy luftërave botërore, të cilat lanë gjurmë edhe në pragun e shtëpisë së tij. Në këto pjesë të përzgjedhura, zbulohet se jeta e shkrimtarit, që nga lindja e tij është e lidhur pazgjishmërisht edhe me fatet dhe historinë e vendit.<sup>5</sup>

---

<sup>5</sup> <https://shqiptarja.com/fotogaleria/doreshkrimet-biografia-e-panjohur-e-dritero-agollit>

njeri i rëndë, i zgjedhur dhe mbi të gjitha  
të tregonte për jetën e vet. Edhe kur mategj të  
koshite ndonjë gjë, i binte shkurt: «isha  
edhe unë atje; kishite shumë; u rrezatuj-  
fek; u vranë; ikëm». Vetëm gjyshja i  
tregonte ngjarjet gjatë. Por edhe asaj nuk  
mund t'i besojë, pasi ngjarjet të vë-  
teta u jepte formën e përballave. Fjala,  
një, unë nuk besoj se tim atë grekërit  
ia kishin vënë kokën në kërcën dhe  
lonin t'ia paguin. Duke patur nga një  
në fakte të pakta të vërteta, <sup>nga im atë</sup> dhe nga  
nga tjetër fakte të shumta imagjinare  
ga gjyshja, unë jam kursyer në për-  
rimin e kësaj copëze jete të tim atë.  
Gjyshja ishte e kualitshme. Kur unë i  
sha se s'trim pasqesh qënë im atë, kur  
e kishin zënë grekërit në gjurmë, ajo për-

me kujtoben ngjarjen  
Tregojmë se lindi afër mëngjesit  
të martën më 13 tetor të vitit që zura  
ngojë pak më lart. Po të kisha qënë i  
bir i ndonjë tregtari të pasur të kor-  
çës, lindja ime do të ishte shënuar  
me një faqet e ndonjë gazete të qytet-  
it. Po në shtëpinë tonë, në fshatin  
Mankulas, ka qënë një fletore e  
troshë me kopakë lëkure, ku shëno-  
heshin emrat e atyre që lindnin  
dhe të atyre që vdisnin. Atje ishte  
edhe emri im. Me një req që kjo  
fletore humbi në kohën e luftës  
së Dytë Botërore, pasi i kishte shpë-  
tuar të Porçës. Shkrimet atje ishin  
të përzjera me shkronja arabe, greke

-11-

dhe latine. Kjo fletore quhej «Me-  
xhuma» dhe mbarhej në sëndukun  
e gjyshes. Kur bynë gjermanët në  
shqipëri, në dimrin e 1944-s, bashkëpunë-  
torët e tyre kugare e grabitën tok  
me plotkat e tjera edhe sëndukun  
e gjyshes, të përçjellë me mallki-  
met e saj të padobishme.

Një javë pas lindjes sime gjyshi  
i hipi karit dhe u nis për në tegene  
e Kucit të Devollit një dymbëdhjetë ki-  
lometra larg nga fshati ynë. Atje takoi  
baba Ahmetin, një burrë i shkurtër me  
një mjekër të zezë e me tas të bar-  
dhe veshur me brez të gjelbër deri  
në majë, njeri i kënduar, që dinte turqisht,  
italisht dhe frëngjisht, pasi, siç thoshin,  
kishte qënë në Francë në ministriat e  
Lionit dhe kishte rënë në kontakt me  
kulturën franceze, sidomos me atë të  
iluministëve. Gjyshi i tha se i kishte  
lindur një nip dhe emrin duhej t'ia  
vinte vetë baba Ahmeti. Kalin gjyshi,  
kalin baba Ahmeti dhe të dy në shtë-  
pi, në Menkulas

Sipas të thënave të nënës, u bë një  
darkë, që nuk do të harrohej kurrë, u  
shtrua sofra e madhe sa një lëmnë me

es: e, po luani fle, se s'ka frikë. I  
ndonjë lepur që të flerë? Lepuri  
therrë nuk e gënë në gjumë. Lepuri  
fle, se ka frikë. Edhe ti pse djers  
fle. Djersin se ke frikë. Ai që nuk  
frikë, fle dhe nuk djersin. Piz  
është nga ata burra që djersin  
në gjumë, ai djersin në nga  
në tokë, dhe nuk djersin në  
f të bardhë.

shite e çuditshme gjysheja ime. Ajo ç  
kthehte përmbys, edhe të keqen  
të mirën. Ajo edhe kur dëgjonte  
që ankohesh nga sëmundja, th  
duart lart nga qielli: «O, Haxh  
Velin, mirë që nuk më dhes  
në trup, se po të më dhembe

#### 1.4. Veprimtaria letrare

Dritëro Agolli, është një nga personalitetet më të shquara të letërsisë shqipe. Është poet, prozator, publicist dhe kritik. Krijimtaria e tij letrare dhe publicistike, është shumë e pasur. Ai me krijimtarinë e tij, letërsinë shqipe e ka prezantuar denjësisht në aspektin global. Pa dyshim është njëri prej personaliteteve më dinamike e më kreative në letërsinë tonë. Vepra e tij është e përkthyer në disa gjuhë të botës.

Dritëro Agolli, është ndër figurat më të spikatura të letërsisë shqiptare. Një auotorsi të begatë e shumëllojshme, aq sa poet i shquar edhe prozator i një niveli të lartë, edhe përkthyes gjithashtu. Tek Dritëro Agolli gërshetohen; lirizmi i poetit, mendimi i thellë e plotë jetë i tregimtarit dhe ndjenja kombëtare që e shoqëron pandërprerë në rrugën e tij krijuese.

Është simboli i mishërimit të butësisë dhe të mënçurisë popullore si një personalitet i



pakufijshëm, si njeri, i gjerë si deti nga  
përkushtimi shpirtëror, plot parime dhe  
idealizma në betejën e përparimit, vizionar në aksionin politik, me një  
shqiptarizëm të spikatur.

Tek Agolli, shqiptari dhe poeti janë të  
pandarë, i pari i jep modelet të dytit, ndërsa  
ky i fundit u jep jetë shtatoreve që ngre kohë  
pas kohe, dhe kështu ushqejnë njëri-tjetrin. Po

ku qëndron madhështia e Dritëro Agollit do pyes lexuesi, ndoshta edhe ndonjë kritik apo  
studiues? Me tematikën diapazonale që ka trajtuar në poezinë e tij, nga fillimet e deri në  
rreshtat e fundit që ka shkruar, kush janë dhe nga vijnë personazhet e prozës së publikuar,

shfletoni poezinë franceze, angleze dhe ruse që ka përkthyer. **Lexoni**  
poemën e mrekullueshme “Devoll-Devoll”  
dhe do të zbuloni përmasat e krijuesit.

Për nga gjinitë, krijimtaria e Dritëro  
Agollit është e larmishme. Në vjershat dhe  
poemat e Dritëro Agollit gjejnë shprehje

mendimet dhe ndjenjat e njeriut të ri, patriotizmi dhe besnikëria ndaj idealeve revolucionare, cilësitë e tij morale në jetë dhe në punë (Devoll, Devoll, Poemë malore, Hapat e mia në asfalt etj.). Vepra e tij poetike më e shquar është “Nënë Shqipëri” (1975), ku krijohet figura e Atdheut me traditat heroike, me vështirësitë e shumta që ndeshi në rrugën e vet dhe me vendosmërinë për të përballuar çdo pengesë e armik. Në poemën

“Baballarët” theksohet rëndësia e veçantë e vijmësisë së traditave revolucionare në jetën e shoqërisë.

Në prozë bëri emër sidomos romani “Komisari Memo” (1969), në të cilin pasqyrohet roli i madh edukues dhe drejtues në vitet e Luftës ANÇ. Nga ngjarjet e kësaj

periudhe e merr subjektin edhe romani “Njeriu me top” (1975), që flet për ndikimin e luftës çlirimtare në mentalitetin e njerëzve. Dritëro Agolli ka botuar edhe mjaft tregime e novela nga jeta e sotme. Ndër krijimet satirike romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” (1973) vë në lojë konformizmin, servilizmin dhe vanitetin si shfaqje të huaja për njeriun e ri.

Vepra më e rëndësishme idealizuese dhe njëherësh më e angazhuar e tij është poema “Nënë Shqipëri”. Gjatë gjithë rrugës së vet krijuese më se gjysmëshekullore, Dritëro Agolli është poeti i dhimbjes njerëzore dhe i filozofisë jetësore. I

vëmendshëm ndaj dramave të mëdha të popullit, ai u bë njëherësh poeti i dhimbjes vetjake të njeriut. Dritëro Agolli njohu një ringjallje poetike në dy dekadat e fundme. Me vëllimet poetike “Pelegri i vonuar”, “Lypësi i kohës”, “Fletorkat e mesnatës” autori

shpall sfidën e tij të re të mjeshtërisë. Në këto vëllime shpërfaqet poeti me ideal të tronditur, që duhet të gjejë vlerën dhe kuptimin e jetës së vet dhe të brezit që përfaqëson në kushtet e tronditjeve të mëdha të shoqërisë dhe të ndryshimeve rrënjësore të rrugës drejt së ardhmes së saj.

Problemin kryesor të zhvillimit të letërsisë, Agolli do ta vërejë qysh në fillim të krijimtarisë së tij, kur depërton në thellësinë e shpirtit të njeriut shqiptar, në enterierin e vetëdijes së tij. Ky poet shpresëplotë dhe i dëshirueshëm, është madhështi e pandryshueshme dhe e jashtëzakonshme. Mjetet e gjuhës së tij dhe metaforika mund të vjetërohen, por esenca e veprës së tij poetike nuk mund të humbasë, siç mendojnë disa studiues dhe kritikë letrarë, kur flasin për disa vëllime poetike të D. Agollit, që i përkasin

kohës së realizmit socialist, me të cilët ne kemi mendim të kundërt. **Prandaj,**  
**duke e cilësuar Agollin si një poet të madh,**  
**është e rëndësishme që sa më shumë të**  
**thellohemi në veprën e tij për të nxjerrë në**  
**pah vlerat e veprës së tij.**

Siç e thotë studiuesi i njohur i letrave shqipe, Dr. Moikom Zeqo, tek libri i tij “Liriku i tokës, demoni i fjalës”, një libër intim kushtuar poetit të madh: “Dritëro Agolli është një nga shkrimtarët më të shquar shqiptarë. Ai ka krijuar profilin e tij si një shkrimtar i traditës, por jo thjesht tradicional, i cili ka një shpirtëzim të botës shqiptare si një aspekt të jetës e të motiveve letrare përmes të cilave të kujton personalitete lirike shqiptare të kohërave nga Naim Frashëri deri tek Lazgush Poradeci”. Dritëroi gjithnjë është treguar i ndjeshëm ndaj dashurisë si ama e jetës sonë, po aq ndaj dinjitetit të jetës së grave dhe vajzave, ndryshe ndaj seksit të bukur, siç e vlerësonte Migjeni, poeti ynë i madh, duke iu referuar kritikut të madh rus, Bjelinskit. Për Dritëroin dashuria nuk plaket kurrë, po aq nuk njeh moshë, kurse gruaja, në përgjithësi, është si ajri që thithim, është oksigjeni i jetës.

Në këtë kontekst poeti ynë i madh vjen sa aktual, sa universal me mesazhet e veprës së vet, përballë skllavërimit postmodern, me të gjitha larmitë e shfaqjes së tij, sa të dukshme, sa të padukshme, shprehje e ndotjes patriarkale, mesjetare, në një shoqëri, si kjo jona, që rreket të jetë e njerëzve të lirë, edhe pse, për hir të së vërtetës, vazhdon po aq të mbetet peng i “zhurmave të erërave totalitare” sa kohë që vetë fati ynësi komb do të mbahet peng i një sjellje për t’u qarë e për t’u qeshur.

Përveç vlerave të larta si poet, krijimtaria e Agollit zë një vend të veçantë edhe në prozë. Në këtë zhanër do të përmendim shtatë romanet e tij siç janë: *“Komisari Memo”* (1970), *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”* (1973), *“Njeriu me top”* (1975), *“Trëndafil në gotë”* (1980), *“Dështaku”* (1991), *“Kalorësi lakuriq”* (1996), dhe *“Arka e djallit”* (1997).

Letërsia e D.Agollit përmban një galeri njerëzish dhe karakteresh. Njeriu është fuqia e brendëshme e veprës së D.Agollit. Në prozën e D.Agollit, njeriu shpesh shfaqet apo kuptohet bashkë me titullin e veprës si psh. *„Njeriu i mirë”*, *„Njeriu me top”*, *„Njerëz të krisur”*, *„Njeriu*

*me veladon”, „Portret i njeriut t; madh” etj. Siç*

e shohim në të gjitha rastet, njeriu i Agollit paraqitet si (*i mirë, i krisur, i çuditshëm, i madh*) e jo të shfaqet me emra ideologjik si „*i ri*”, „*heroik*”, „*revolucionar*” etj.

Në prozën e Agollit nuk mbizotëron ajo letërsi, e cila si temë kryesore e ka luftën. Libri me tregime „*Zhurma e erërave të dikurshme*”, i cili sipas Ismail Kadaresë është njëri ndër librat më të mirë të kohës, i botuar në vitin 1965, shmang paraqitjes e luftës bardh e zi dhe për këtë shkak ishte i kritikuar dhe i tërhequr nga tregu, si prozë me prirje deheroizmi.<sup>6</sup>

Ditët për një të ardhme më të mirë, besimii dhe entuziazmi i njerëzve, lufta për çlirim që do të buzëqesh drejt së nesërme janë temë frymëzimi në tregimet e Dritëro Agollit.

“*Komisari Memo*” (1970) është një libër që shpesh është gjendur i ekspozuar ndaj kritikës. Së pari, sepse vetë figura qendrore e romanit, komisar Memo, është brenda llojit të njerëzve të krisur. Komisar Memo, patriot i një kohe të re e gjen pa vështirësi gjuhën e komunikimit me shqiptarin e vjetër patriot, komandantin Rrapo, që ngjan si i thirrur prej kohës së komitëve. Komisar Memo është një figurë pozitive. Në një çast ai nxehet dhe në vend që ta bindë komandantin Rrapo me argumente, i nxjerr pistoletën.

Në romanin “*Njeriu me top*” (1975) Dritëro

Agolli zbuloi marrëdhënie tjetër, krejt të ndryshme nga ajo e “*Gjeneralit të ushtrisë së vdekur*” të Ismail Kadaresë, sa i takon raportit të njeriut shqiptar me armën. Zot e rob i pushkës, i magjepsur prej saj ky njeri bën çudira nga më të pabesueshmet.

Me romanin “*Tëndafil në gotë*” (1980)

Agolli provoi të bënte një sfidë tjetër në letërsi, duke krijuar një vepër me një personazh

---

<sup>6</sup> Ali Aliu, *Don Kishoti shqiptar*, Tiranë, 2010, f. 213

që gjendet midis dashurish, pa tema epokale, pa epokizëm dhe heroizëm. Në këtë roman Agolli krijoi njeriun hero për merita të dobësisë.

Në romanin “*Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*”, subjekti rreh të zbulojë te protagonistin tipin e burokratit mëndjemadh, që është disi jashtë realitetit dhe që shfrytëzon punën e të tjerëve. Në pozita qesharake vihet Zyloja i shkarkuar nga detyra dhe që prap “nuk e humb toruan”, por jep porosi, këshilla e orientime për mbarëvajtjen e punës në sektorin që po lë. Vlera e këtij romani nuk qëndron në paraqitjen e tipave që karakterizohen nga cilësi të mira, madje edhe zbehtësia e tyre si tipa pak ndjehet në vepër. Megjithatë tërë mjedisi që ndikon në veprimet e mendësitë e vetë atij bëjnë të zbulohet komizmi i tij.<sup>7</sup>

Zyloja i Dritëroit ofron mjeshtërisht monumentin e tharjes “institucionale” të vetë qenies, si sindroma me një imunitet të frymëzuar ekzistencial, ndryshe si dilema më tragjikomike mes qenies dhe mosqenies, që rrezikon tharjen tashmë përfundimtare të vetë njeriut modern nën ethet e kultpragmatizmit dhe të individualizmit ekstrem.

Personazhet e veprës së Dritëroit, përgjithësisht, dëshmojnë për tabanin demokratik, aspak si slogan i thjeshtësisë komuniste, ndryshe si diçka e kërkuar, por si gjetje artistike, vlerat e së cilës si letërsi e madhe, do të thoshte Bjelinski, vijnë gjithnjë në proporcion të drejtë me thjeshtësinë brilante të komunikimit me lexuesin e vet. Ato kurrësi s’vijnë nga atelia e heroit pozitiv, si moduli i njeriut të ri, që orientohej nga lart.

Romani “*Arka e Djallit*” u përfundua në fillim të viteve ’90. Nuk është e rastit që Agolli, duke e quajtur romanin e tij “*Arka e Djallit*”, që nënkupton sëndukun ku mbahet e kyçur vepra e ndaluar e Bankë Dynjasë i ka paralajmëruar atij një fund të trishtuar.

---

<sup>7</sup> Jakup Mato, *Paradokset e satirës dhe të humorit*, Tiranë, 2000, f. 124, 125, 126

Dritëro Agolli thotë: “Kam edhe një libër që e kam shkruar 40 e ca vjet më përpara, por nuk e kam botuar për disa arsye. Është një roman që quhet “*Vrasja e kukuvajkës*”. Kam edhe shënime të ndryshme, një libër që mendoj ta botoj më përpara.

Në mesin e viteve '70 një teatër vuri në skenë dramën e tij “*Baladë për një grua*”, ku personazhi qendror, një aktiviste e partisë në rreth – anëtare byroje – voton kundër përjashtimit të ish-burrit të saj nga partia, por duke zbritur shkallët pas mbledhjes i thotë: “Ti je i denjë për të qëndruar në parti, por jo për të qenë burri im”. Ishte një “kundravajtje ideologjike” që nuk mund të falej. Sipas vijës duhej të ndodhte e kundërta: marrëdhënia në familje vinte si rrjedhim i mbetjes ose jo në parti. Shfaqja u ndalua dhe drama nuk u botua më. Edhe dramat “*Fytyra e dytë*” e “*Mosha e bardhë*” nuk u pritën mirë nga kritika zyrtare.<sup>8</sup>

Në dramën-satirë “*Fytyra e dytë*” të D. Agollit komizmi në figurën e Bektash Shkozës buron nga kontradikta midis veprimeve e mendësive të vjetra e diktatoriale të këtij tipi dhe paraqitjes së jashtme si një kuadër parimor që zotëroka dialektikën dhe gjoja mban qëndrim ndaj dukurive të vjetra e shfaqjeve të ulëta. Krahas tipareve negative, në veper janë treguar edhe përpjekjet që bën ky personazh për t’u dukur një njeri i përparuar. Komizmi i figurës qëndron, pra, në mospërputhjen e fjalëve të bukura me veprimet e shëmtuara. Autori tallet, përqesh me ashpërsi disa cilësi e shfaqje negative të tipave burokratë, injorantë, por edhe të rrezikshëm, ose me pasoja të dëmshme për shoqërinë.<sup>9</sup>

---

<sup>8</sup> Grup autorësh, *Gjuha shqipe dhe Letërsia 4*, Tetovë, 2004, f. 117

<sup>9</sup> Jakup Mato, *Paradokset e satirës dhe të humorit*, Tiranë, 2000, f. 32, 58



Por, për fat të keq në periudhën e totalitarizmit D. Agollit iu hoqën nga qarkullimi disa komedi, ndër të cilat ishin “*Fytyra e dytë*” dhe “*Në moshën e rinisë*”.

Thamë se Dritëro Agolli është marrë edhe me publicistikë. Në vazhdim do të përmendim disa përshkrime dhe reportazhe të Agollit, të botuara në gazetën “Zëri i popullit”, siç janë: *Poema e një lumi dhe një lugine, Lugina e zgjuar, Zëri i popullit: 4361 të shtëna...*, *Anës Kurorës së Lurës, Simfoni gjirokastrite, Shënime për gratë e Mirditës, Rini e 1967-s, Nisi në një shtëpi në Tiranë...*, *Një perlë në Myzeqe, Me oshëtimën e Nëntorit, Bakri, teli dhe drita, Buka dhe drita, Mposhtja e Drinit, Devolli dhe devollinjtë, etj.*

Në të njejtën gazetë Agolli botoi edhe disa portrete si: *Në prag, Një shtëpi buzë udhës, Tregime për shokët e mi, Biri i Partisë, Margaritarët e zemrave, Njeriu dhe fabrika, Vajza myzeqare, Një faqe nga biografia, Etër dhe bij, Kronika e jetës së një njeriu, etj* si dhe disa fejtone, siç janë: *Drejtori buzëqesh, Sikur...*, *Dysh në fizikë, Po të duash këndo, po të duash luaj valle!, Fustani i zi, Furtunë fletësh, kpitujsh, nenesh...*, *Kur bëmë celebrimin unë dhe Lulushja...*

## “*Zhurma e erërave të dikurshme*”

(1964), një përmbledhje me tregime, që u hoq nga qarkullimi për nxirje realiteti.

Ky libër u botua në vitin 1964. Libri nuk doli në qarkullim, sepse u ndalua atëherë. Sipas atyre që e ndaluan, ky libër nuk paraqiste realitetin e atëhershëm socialist në mënyrë optimiste por, ishte një libër pesimist. Heronjtë dhe personazhet e librit, sipas tyre, dukeshin të mërzhitur, jo luftëtarë, por njerëz me lëkundje shpirtërore dhe në përgjithësi, deheroizoheshin. Këto ishin vërejtjet që u bënë atëherë, prandaj botimi i parë, nuk doli në shtyp. Më pas, doli botimi i dytë, nga i cili u hoqën disa tregime, e pastaj doli në qarkullim. Kur doli në qarkullim, përsëri u ndalua, pas një plenumi të komitetit qendror (plenumi i 15-të, në vitin 1965), një vit para përpjekjeve për të dalë ky libër. Kur doli, përsëri ai u kritikua dhe më vonë u ndalua, si i tillë. Por, ka edhe një ngjarje të çuditshme! Mua më kishte mbetur vetëm një kopje e librit, e botimit të parë, me një kopertinë tjetër,

sepse libri doli me disa kopertina, po në vitet 60-të, dhe më kishte mbetur vetëm një kopje. Ndodhi që në vitin 1972, erdhi këtu më një delegacion nga Kosova, Hasan Mekulli. Ai më kërkoi një libër që ta lexonte. Unë i dhashë kopjen e vetme që kisha, me një kopertinë të piktores së dëgjuar, Safo Marko, gruas së Petro Markos. Për çudi, Hasan Mekulli, e botoi në Prishtinë, duke lëshuar edhe dy – tri, tregime që i kisha botuar unë më vonë, por edhe ata të ndaluar, me një titull “*Njeriu i mirë*” dhe me një parathënie shumë të mirë që e kishte shkruar ai. Aty ishte një tregim, “*Njeriu me veladon*”, që ishte i ndaluar plotësisht që në botimin e parë. Për herën e parë si botim, u botua në atë përmbledhjen që e kishte bërë Hasan Mekulli. D.m.th., për herë të parë u botua për publikun në Kosovë. Pas dhjetë vjetëve disa tregime të këtij libri dolën në përmbledhjen time. D.m.th., dhjetë vjet pasi e kishte botuar Hasan Mekulli. Ishte kjo përmbledhje me dhjetë vëllime e botuar nga shtëpia botuese “Naim Frashëri”. Ky libër u bë i njohur pa thënë që janë tregime të librit “*Zhurma e erërave të dikurshme*”. U botua vetëm në vitin 1995, në kohën e demokracisë dhe falë atij botimi të Hasan Mekullit, unë e botova në librin “*Zhurma e erërave të dikurshme*” – thotë Dritëro Agolli.<sup>10</sup>

Personazhi kryesor i “zhurmave të erërave të dikurshme” s’është tjetër vetëm modeli i antiheroit, individualisti, i cili “suksesin kolektiv” e sheh vetëm si fillim të jetës me “sukses të vetmuar” sipas motos individualiste: “Bota ekziston vetëm brenda meje...”

Nga pikëpamja letrare, këto tregime, një pjesë e të cilave u ribotuan në **librin** “*Njerëz të krisur*” (1995), janë të mbushura me personazhe atipike, me karakter e pamje të paskalitura, me individualitete jashtë standartit, gjë që përbënte një largim të hapur nga parimet e metodës skematike zyrtare.<sup>11</sup>

Në vitin 1987, unë e botova një cikël me tregime, në revistën “Nëntori”. Ishin tregimet që i kam përmbledhur edhe në këtë libër, sepse kanë pasur të njëjtën histori.

<sup>10</sup> Intervistë e Radio “Blue Sky” nga Vera Pelaj më 9.12.2006

<sup>11</sup> Grup autorësh, *Letërsia bashkëkohore shqiptare*, Tetovë, 2001, f. 137

Tregimet “*Martesa e papritur e Pasho Velqanit*”, “*Djali pleng prishur*” etj, por edhe këto, fatkeqësisht u ndaluan. Kështu që, unë nuk kam pasur fat të madh në tregime, thotë Agolli.

Në tregimin “*Portreti i njeriut të madh*” Dritëro Agolli përdor elementet e karikaturës për demaskimin e snobit që mendon se në shoqëri ai ka një vend të veçantë. Ky tip mban disa poza për t’u dukur, i jep rëndësi vetes, përpiqet të duket në çdo gjë origjinal. Ai e mban kokën mënjanë, sikur do të kundrojë veten, flokët i lyen me bojë, për të fshehur thinjat. Llulla në njërin dorë e receptorin në tjetrën, fletët e shumta grumbulluar mbi tavolinë, librat e trashë që nuk i lexoi ndonjëherë, përvijojnë me mjete të karikaturës këtë figurë.<sup>12</sup>

Agolli gjithashtu ka shkruar edhe novela ndër të cilat do të përmendim “*Njeriu i mirë*” dhe “*Apasionata*”.

Në përrallëzën e Dritëro Agollit “*Mullixhiu dhe pulat*” përqeshet një tip i tillë që faktin pse s’po vjen uji i mjaftueshëm në jazin e mullirit, ai e shpjegon se pula pi ujë në të.

---

<sup>12</sup> Jakup Mato, *Paradokset e satirës dhe të humorit*, Tiranë, 2000, f. 254

Dritëro Agolli veç të tjerash është edhe lëvrues i fabulës. Ai ka krijuar subjekte origjinale, ose ka përpunuar disa subjekte të mirënjohura, në të cilat nxirret në pah një moral me interes për bashkëkohësit. Idetë e këtyre fabulave nuk theksohen në mënyrë të veçantë, po burojnë nga vetë subjekti dhe konteksti i krijimit. Në fabulat e Dritëro Agollit përzihet shpesh përralla me ngjarjet reale. Autori ruan intonacionin e rrëfimit popullor dhe përmes detajeve, konkretizon dukurinë bashkëkohore. Këtu mund të përmendim fabulën “*Maçoku dhe minjtë e vegjël*”.<sup>13</sup>

---

<sup>13</sup> Jakup Mato, *Paradokset e satirës dhe të humorit*, Tiranë, 2000, f. 123

## KREU II

### 2.1. Struktura narrative dhe galeria e personazhëve

### 2.2. “Komisari Memo”

## Romani “Komisari Memo” (1970) është vepra

më e angazhuar e Dritëro Agollit në prozë. Në të autori poetizoi „kohën e komisarëve”, që ishte pjesë e kultit të luftës antifashiste, e cila sundoi për shumë kohë letërsinë shqipe. Figura më e plotë e romanit është komandanti Rrapo, i cili bën pjesë brenda llojit të “njerëzve të krisur”, që përmban në tërësinë e vet letërsia e Dritëro Agollit. Pavarësisht karakterit të skalitur e tejet epik, si gur i palatuar, të burrit shqiptar Rrapo Tabani, pavarësisht bukurive të larmishme të veprës, figura e komisarit Memo është në qendër të gjithë frymës së librit, është vetë figura e tij.

E gjithë mjeshtëria e Dritëro Agollit, në të gjithë prozën e tij më të mirë, atë epike, qëndron në ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet dy tipeve të shqiptarëve: shqiptarëve – Rrapo dhe shqiptarëve – Memo, ndërmjet dy brezave, burrave dhe të rinjëve.

Te “Komisari Memo” lexuesi gjen një tablo realiste të kohës, një tablo, e cila pikërisht për shkak të funksionit të veçantë të letërsisë së mirë artistike në krahasim me letërsinë shkencore, ndikon drejtpërdrejt mbi ndërgjegjen e lexuesit dhe e mbush atë më shpejt dhe në mënyrë më të qëndrueshme se veprat shkencore.<sup>14</sup>

Romani fillon me bartjen e bustit të bronxtë drejt fshatit Lumëz dhe vazhdon të tregojë të gjitha ngjarjet e përjetuara të komisarit Memo, të gjitha vështirësitë që kishte kaluar. Përshkruhet plagosja e rëndë e Memos dhe qëndrimi i tij në shtëpinë e doktor Kristo Borovës, i cili e operoi në shtëpi dhe aty qëndroi disa ditë deri sa u shërua. Pikërisht në këto ditë, komisar Memo njihet me Almën – vajzën e doktorit, në të cilën edhe u dashurua. Alma ishte një vajzë e re, e bukur, me shtat të lartë dhe flokë të gjata. Ajo ishte e fejuar me Spiron, i cili ishte simpatizant i gjermanëve. Ngjarja vazhdon me shumë beteja të tjera deri në momentin kur komisar Memo së bashku me komandantin Rrapo u nisën në betejë kundër gjermanëve. Bashkë me Memon dhe Rrapon u nisën edhe

---

<sup>14</sup> www.gsh.al

Fatja dhe Demka. Nurka me grupin e tij mori udhën e Lumësit, kurse Memua atë të Dushkut. Këmbët u shkisnin nëpër dëborën e ngrirë dhe herë-herë binin nëpër gropa. Ndërkohë u dëgjua një breshërimë automatiku. Në fillim ata nuk e ndjenë nga erdhi kjo breshërimë. Kur u dëgjua breshërima e dytë, Fatja vuri re se në mes të katër borigave diçka e zezë lëvizi. Fatja qëllloi me pushkë. Ai thirri Memo. Por Memua u lëkund mbi dëborë me duar në krahërorë. Lëkundja e tij zgjati edhe disa sekonda. Fatja ndjeu kërcitjen e dëborës së ngrirë. Ktheu kokën dhe pa komisararin të shtrirë. Atëherë Fatja u turr drejt katër pishave me pushkë në dorë. Demka rrinte te koka e komisararit. Ai që shtyu me automatik, vraponte në errësirë. Fatja e ndiqte pas, e qëllonte. Demka e ngriti komisararin në krahë dhe u nis për në batalion. Fryma e komisararit nuk ndjehej. Demka ndjente vetëm ngrohtësinë e ballit të tij që i prekte faqet gjatë ecjes. Ende i gjallë, mendonte ai dhe ngjitte malin. Kur arriti afër kolibeve, qafa, faqet dhe balli i Memos ishin bërë të ftohta si akulli. Me trupin e komisararit në krahë ai iu afrua kolibes së komandantit Rrapo. E shtyu derën dhe hyri në kolibe. Rrapua dhe Xhemali u hodhën në këmbë.

Demka nuk fliste dot. Ai qëndronte në mes të kolibes me trupin e Memos në krahë. Vdiq! – tha me një zë të dredhur. Na e vranë komisararin, Xhemal! – tha Rrapua dhe u ul te koka. Ishte plagosur rëndë, kishte humbur gruan, kishte lënë fëmijën e vetëm nëpër stanet e çobenjve dhe nuk kishte ndjerë një dhembje kaq të thellë.

Komandanti Rrapo doli jashtë duke vrapuar dhe shkoi te partizanët për t’u treguar se e kishin vranë komisararin Memo. Partizanët e batalionit “Shkrepëtima” u nisën pas komandantit Rrapo. Nga mesi i partizanëve u shkëput një vajzë dhe hyri në kolibe. Para saj qëndronte i shtrirë Memua. Vajza u hodh mbi të, e pushtoi me të dy krahët dhe filloi të qante me dënesë. Ajo ishte Alma.

Në sheshin e staneve ra mëngjezi. Batalioni ishte rrjeshtuar para varrit të komisararit. Memon, të veshur me kapotën e tij, e kishin vënë në një lesë të thurrur me shufra. Pranë krahut i kishin vënë pushkën dhe në brez nagantin. Dukej sikur flinte i pushtuar nga një gjumë i thellë. Komandanti Rrapo foli disa fjalë dhe tha se ëndrra e komisararit ishte liria dhe komunizma prandaj ne duhet të luftojmë për lirinë dhe komunizmen.<sup>15</sup> Të gjithë u betuan se do të luftojnë për ta realizuar ëndrrën e komisararit

---

<sup>15</sup> Dritëro Agolli, *Komisari Memo*, Prishtinë, 1972, f. 315

Memo. Xhemali dhe Hodo Allamani e zunë lesën dhe e ulën në varr. Kur mbi varrin e komisarit hidhnin dheun e fundit, në sheshin e staneve arrinë Fatja, Mevlani dhe tre partizanët që ishin dërguar në kërkim të dezertorit. Para tyre ecte një burrë me duar të lidhura. Ishte Zariku. Zariku ishte futur në batalionin “Shkrepëtima” nga Bamka dhe Salih Protopapa për të vrarë komandantin Rrapo. Me këtë vrasje ai donte të ngjallte frikë e panik. Pas kësaj pune të poshtër, ai kishte shpresë të merrte vetë drejtimin e batalionit. Kur erdhi komisari Memo, djallëzitë e Zarikut dështuan. Batalioni u bë më i fortë. Atëherë ai mori urdhër të vriste komisarin Memo. Urdhërin ja solli vetë Qanua.

Zariku kokëulur here rëndonte në një këmbë here në tjetrën. Komandanti Rrapo nxori nagantin dhe qëlloi tri here. Zariku u vërtit rreth vetes, duke u lëkundur dhe ra me kokë në tokën e njomë të varrit të komisarit.

Romani përfundon me arritjen e bustit të bronxtë në fshat, ku të gjithë fshatarët kishin dalë ta prisnin komisarin. Bustin e kishte ndërtuar skulptori Andrea Borova dhe tani busti duhej të shkonte në fshatin Lumëz e të qëndronte në atë shkëmbin e çuditshëm në mes të fshatit. Ishte guri ku komandanti Rrapo bënte planet e tij.

Atëherë rreth këtij guri u mblodhën të gjithë për të parë Memon.

### 2.3. Galeria e personazhëve

Memo Kovaçi është prototipi i heroit partizan të ndërgjegjshëm me një rol të dyfishtë: të bëjë luftë në male kundër pushtuesve gjermanë dhe të bëjë punë edukative mes popullit si komisar politik. I plagosur në një betejë, Memon e trajton për ta shëruar një mjek që orvatet t'ia dobësojë bindjet politike duke i mbushur mendjen se asnjënjësia është zgjidhja më e qëlluar në kohë trazirash politike. Memoja ka përballë edhe Rrapo Tabanin, komandant batalioni, i cili ndërhyrjen e komisarëve politik e sheh si në dëm të aftësive luftarake të forcave të tij. Busti prej bronzi, i ngritur në kujtim të Memo Kovaçit në fshatin e lindjes pas vdekjes, është simbol i rëndësisë që partia i jepte edukimit politik e ideologjik.<sup>16</sup>

**Komisari Memo** është një trim i pashoq, i cili është i gatshëm të shkojë deri në fund kundër armikut, kurse komandanti Rrapo s'e ka shoqin në betejë dhe gjithmonë gjen zgjidhjen më të mirë të mundshme.

Komisari Memo dhe komandanti Rrapo janë dy botë por një rrugë, një objektiv i përbashkët i luftës shqiptare për ta çliruar atdheun. Pra, edhe njëri edhe tjetri për synim kanë dëbimin e pushtuesit të huaj. Komisari Memo është për luftë sipas rregullave të njohura dhe ideologjisë komuniste, kurse komandanti Rrapo sipas traditës dhe instiktit popullor të trashëguar gjatë shekujsh. Përplasja e tyre është për jetë a vdekje.

Komandanti Rrapo është figura më markante, një ndër të rrallat në mesin e personazheve të ptozës shqiptare nga lufta. I tërhequr, por jo i mposhtur, ai i ka të gjitha simpatitë e autorit dhe del personazh më pranë natyrës së vetë Dritëro Agollit: karakterin shqiptar të formuar ndër shekuj nuk e ndërron. Është një origjinalitet i Dritëro Agollit, i cili edhe pas aq miqësive të shumta e të mëdha me kryeshkrimtarë dhe kryevepra letrare botërore, mbetet gjithësesi shkrimtari më origjinal i letërsisë shqipe të kohës së vet.<sup>17</sup>

---

<sup>16</sup> Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Pejë, 2001, f. 407

<sup>17</sup> Ali Aliu, *Don Kishoti shqiptar*, f. 223, 224



## 2.4. “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”

“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” është kryevepër e Dritëro Agollit, e cila llogaritet si kontributi më i rëndësishëm letrar në prozë për një shumicë lexuesish. Romani është i ndarë në disa kapituj, ku në secilin prej tyre qëndron vëmendja tek personazhi kryesor i kësaj vepre që është, shoku Zylo, kurse personazhë dytësor paraqiten Demka, Komisari Memo, Shoku Q, Shoku Shemsedin etj.

Ngjarjet në këtë roman zhvillohen në kohën kur vendi ynë ishte një diktaturë. Ky roman trajton një nga çështjet më aktuale për atë kohë dhe jo vetëm siç është burokracia. Ajo pasqyrohet ndërmjet personazhit kryesor, Shokut Zylo, dhe mjetit artistik kryesor satirës. Shoku Zylo përfaqëson të gjithë zyrtarët e lartë të cilët domosdo janë të prekur nga burokracia e nga detyrat e shumta. Të gjithë këta kanë nga një njeri të besuar, të cilit i besojnë madje edhe fjalimet e jetës, ata më të rëndësishmit. Këta përfaqësohen nga Demka i cili edhe pse jo me dëshirë, por me ‘dhembshuri’ për shokët e mëdhenj u bëjnë shërbime të ndryshme. Që të dy këta personazhe dhe ata që përfaqësojnë nuk mund të bëjnë pa njëri-tjetrin. Puna e shkresat e Zylos nuk bëjnë dot pa dobësinë e Demkës. Lufta kundër pushtetit shfaqet e trajtohet në të gjithë romanin, megjithëse në të njejtën kohë edhe zbutet edhe theksohet nga ironia e thellë. Ky është qëllimi i autorit, me këtë roman ai godet pushtetin e atëhershëm duke u ngritur e rebeluar.<sup>18</sup>

Vepra hapet me përshkrimin e gjendjes apo ngarkesës shpirtërore që ndjente Demka i cili vazhdimisht ngarkonte veten me shkrime, raporte apo diskutime që i kërkoheshin t’i shkruaj nëpër ministri të ndryshme. Puna që ai bënte nuk dukej fare, sepse ai shkruante në emër të tjerëve apo më mirë thënë, shkruante ai dhe lëvdoheshin të tjerët. Duke qenë se nga kjo punë ai stresohej aq shumë, shpeshherë i thoshte Zejnepes, gruas së tij që s’do pranonte të shkruaj më për ministri, por se do të shkruaj për gazeta dhe revista apo edhe ndonjë novelë. Mirëpo, i tillë ishte Demka, këtë e thoshte saherë që lodhej apo mlllefosej kur shihte që për raportet që kishte shkruar ai duartrokitej shoku Zylo apo

---

<sup>18</sup> ese.dhe.projekte/photos/analize-shkëlqimi-dhe-rënia-e-shokut-zylo

Shoku Q për të cilët ai shkruante, sepse, pas njërit i kërkoheshin shkrime të tjera dhe Demka nuk mundte të thoshte jo, madje nuk refuzoi që edhe të punojë me shokun Zylo në ministri dhe të bëhej krahu i djathtë i tij.

Të nesërmen Demka shkoi në zyrë tek shoku Zylo për të biseduar rreth asaj që do të duhej të punonte më tutje. Ai vërejti që Zylo ishte një njeri shumë i zënë me punë dhe se zilja e telefonit të tij binte pa pushim, kështu që në disa çaste edhe ndjeu keqardhje për të. Mbi të gjitha ai priste ftesë në një mbrëmje solemne por që ajo nuk arriti kurrë në duart e tij, mirëpo kjo nuk qe pengesë që ai të ishte prezent në atë mbrëmje ku edhe u takua me shokun Q dhe diskutuan rreth studimeve me të cilat mereshin që të dy.

Shoku Zylo ishte një nëpunës shtetërorë i cili konsideron që e kryen punën e tij me përgjegjësi të madhe dhe se çështjen e shoqërisë e vë para interesit vetjak. Këtë më së miri e shpreh edhe në momentin kur të gjithë shokët e tij i luten dhe i sugjerojnë që ai të pushojë, kurse Zylo në ato moment tregohet edhe pak arrogant duke thënë se në asnjë mënyrë nuk do të vepronte sikur Shemsedini, i cili më parë ishte përgjegjës i këtij sektori. Ai thotë që kurrë nuk do të shtrihej në rërën e bregdetit deri sa gjendja në institucion nuk ishte për t'u lëvduar. Pra, shoku Zylo ishte nga ato njerëz që punonte shumë dhe gjithmonë i dukej pak. Ai gjithashtu nuk ishte njeri që mburrej, ai madje i urrente njerëzit që mburreshin. Këtë më së miri e shohim në momentin kur Diogjeni, djali i tij lëvdon gjyshin e tij duke thënë se ai kishte qenë luftëtarë në Luftën e Vlorës në vitin 1920, kurse Zylo e qorton atë duke i thënë se nuk duhej të mburrej dhe i kujton se edhe gjyshi i Diogjenit nuk kishte qenë njeri që mburrej me bëmat e tij. Madje i kujton që ai edhe intervistë nuk u kishte dhënë gazetarëve të “Bashkimit” vetëm sepse ajo mund të dukej si mburrje.

Zylo ishte njeri interesant. Ai nuk donte të dilte jashtë rregullave të karakterit të ij për asnjë çmim, as edhe kur I ftonte në shtëpinë e tij, ishte që ndjeje frikë se mos gaboje e ai të nervozohej. Kështu një natë teksa po bisedonte me shokët e tij Demkën dhe Bakirin, të cilët i kishte ftuar në shtëpi u dëgjua zilja e shtëpisë e shoqëruar me disa qarje që vinin nga motra e Zylos, e cila kishte ardhur që t'i tregonte që babai ishte sëmurë dhe se e kishin dërguar në spital, mbase për çështje infarkti. Me të kuptuar Zylo shkon në spital për të vizituar të atin dhe atje përsëri ndeshemi me karakterin e fortë të Zylos, në momentin kur babai i tij i gëzohet respektit që po i bënin mjekët dhe mburret me faktin

që sa shumë e respektuan ato Zylon, kurse me këtë nuk mburret Zylo por reagon duke thënë se të gjithë ata ishin mbledhur për të bërë punën e tyre e jo ngaqë Zylo ishte dikushi, e xha Maksuti ishte babai i tij. Pra, motoja kryesore e shokut Zylo ishte punë dhe vetëm punë, e këtë e dëshmon më së miri edhe me angazhimet e shumta që bëri për të pritur disa rapsodë të njohur që do t'i vinin në institucion.

Shoku Zylo ishte njeri shumë i zënë me punë. Në kapitullin në vazhdim atë e shohim të del në terren, ku edhe takohet me shumë njerëz si dhe me kryetarin me të cilin flisnin me kujdes të madh për kulturën, interesohej për grurin, misrin dhe të mbjellat e tjera. Në mbrëmje ai përsëri pati një takim me fshatarët dhe kryetarin, ku ai aty dëgjonte hallet e fshatarëve, hëngrën e pinë me të madhe gjersa u bënë tapë, gjë që më pas shoku Zylo u turpërua për gjendjen e pijanecit në të cilën kishte rënë atë natë. Megjithatë, pasi u kthjell shoku Zylo duke qenë se turpërohej për gjendjen e tij para Demkës, ai arsyetohej se kishte pirë për t'u dukur më i afërt dhe më i dashur me fshatarët.

Ditë e re. Shokun Zylo e shohim të ketë dalë në terren dhe po interesohej rreth banjave për kushtet e tyre, si dhe a kanë intersim njerëzit, i përdorin për t'u larë apo jo? Nëse po kush më shumë, gratë apo burrat? Në gjithë këtë çështje terreni shoku Zylo u ndesh me jetën fshatareske plotë kontradikta, ku në një anë ishte bukuria e natyrës, mikpritja e çiltër, mekanizmi i mjeteve të prodhimit, nga ana tjetër, paragjykimet, kapadailëku dhe nënvlerësimi i kulturës, kështu që shoku Zylo ndihej i paaftë karshi kësaj gjendjeje. Megjithatë, shoku Zylo e donte shumë fshatin, meditonte dhe shkruante rreth tij, rreth natyrës dhe njerëzve, duke nxjerrë kështu më të mirën e tij nga vetja për fshatin dhe bukurinë natyrore.

Me të ardhur në Tiranë shoku Zylo filloi të merej përsëri me shkrimin e referateve të shumta. Ai shkruante që çdo lagje e fshatit duhet të organizonte festivalin e saj, të gjitha lagjet të konkurronin mes vete, në fshatrat e vegjël, të cilët nuk janë të ndarë në lagje, duhej të konkurronin pjesëtarët e dy-tri shtëpive me pjesëtarët e dy-tri shtëpive të tjera. Ai gjithashtu përmes referatit kërkonte që nëpër dasma të mos këndohen këngët e vjetra por të rejat, veç kësaj ai ishte i mendimit që duhej të organizoheshin festivale, takime, olimpiada etj. Mirëpo, ashtu siç merej shoku Zylo me shkrimin e referateve ashtu shkruante edhe shoku Q, i cili zakonisht e thërriste Demkën për t'ia shkruar ashtu siç

bënte edhe Zylo dhe të dy këto gjithmonë kishin mendime të kundërta dhe Demka ishte ai që ngelej në pozitë të rëndë.

Shokun Zylo në pjesën e tretë të këtij romani e shohim të ketë pakënaqësi rreth fushës së dramaturgjisë, veçanërisht të një drame e cila u shfaq në skenë për të cilën ai kishte pritje të tjera por doli të jetë i zemëruar me Zaim Avazin për të cilin ishin shkruar fjalë të mira në një artikull, e që padiskutim shokut Zylo nuk i pëlqyen fare, sepse Zylo ishte njeri që nuk duronte dot të lavdëronin një tjetër pos tij. Ai ishte bamirës, dëshironte të punojë shumë, por në asnjë mënyrë s'mund të duronte që edhe dikush tjetër të ketë të tilla merita.

Pas gjithë këtyre lodhjeve shoku Zylo e pa të arsyeshme se duhet të pushojë. Megjithatë, ai nuk do të ishte një pushim i vërtetë por punë intenzive. Me të në plazh duhej të shkonte edhe Demka të cilit ai i kishte rezervuar dhomën ku do të qëndronte pa e pyetur fare. Rreth shokut Zylo në plazh u mblohdën kritikët Mitro Karapataqi dhe Zaim Avazi, shkrimtari dhe dramaturgu Adem Adashi bashkë me gruan e tij. Edhe pse në plazh ata bënë diskutime të zjarra në lëmin e artit të letërsisë e të kulturës kombëtare dhe ndërkombëtare. Megjithatë, konkluzionet e diskutimit gjithnjë i bënte shoku Zylo. Por, gjatë kohës që po qëndronin për pushime në plazh, shokut Zylo i erdhi thirrja që të nisej urgjentisht për në Tiranë, ku edhe do të ngrihej në post, duke u bërë kështu me detyrën e re të ambasadorit. Me të marrë postin e ambasadorit ai përsëri kthehet në plazh tek gruaja dhe shokët e tij të cilët e prisnin me kureshtje të madhe. Mirëpo, siç edhe e kemi parë, problemet për shokun Zylo nuk kanë të ndalur. Tani atë e shohim t'i digjet lëkura në masë të madhe nga dielli sa që kishte fituar edhe enjtje të mëdha dhe nervat i ishin ngritur si mos më keq. Për këtë gjendje të tij e shohim t'i vijë keq dhe të shfaq kujdes Kleopatra, gruaja e Zaim Avazit, e cila i jep kremin italian për djegie. I gjithë ky kujdes për shokun Zylo bëhej ngaqë ajo e dashuronte atë si e marrë, gjë të cilën ia kishte shprehur edhe atij, por që shoku Zylo nuk dilte nga parimet e hekurta të moralit të tij. Ishte pra ky Zylo, njeriu i moralit, i parimeve, drejtësisë dhe krenarisë, të cilin në fund e shohim tek dorëzon edhe postin e tij dhe nuk përulet aspak.

Ngjarjet në këtë roman zhvillohen në kohën e diktaturës. Aty trajtohet burokracia dhe çështjet më aktuale të asaj kohe. E gjithë kjo më së miri pasqyrohet përmes personazhit kryesor, Zylo, i cili përfaqëson të gjithë zyrtarët burokratë. Të tillët

gjithmonë del të kenë nga një njeri të besueshëm që mbajnë afër vetes. I tillë ishte Demka i cili bënte shkresat që urdhëronte shoku Zylo.

Kritika e autorit në romanin *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”* është e guximshme dhe liberale për kohën kur u shkrua. Neni 55 të burgoste po të kaloje vijat e bardha. Ndaj ai godet me humor e satirë të mprehtë e të mençur fenomenin e burokratizmit, me kulturë dhe shije të lartë estetike. Godet edhe bartësin e tij, i cili ishte jo funksionar në fronet e larta. Kritika shkonte gjer te drejtori i kulturës masive në ministrinë e kulturës, i pagëzuar nga autori me emrin Zylo Kamberi, figurën e të cilit e ka skalitur mjeshtërisht si protagonist komik i romanit. Edhe personazhet e tjerë, tipat dhe karakteret humoristike kanë personale artistike që ngjasin vetëm me vetëveten. Ai që e ka lexuar romanin nuk e harron kurrë Zylo Kamberin me bëmat e tij komike, as Demkën që i shkruante raportet Zylos, por as kritikët servil Mitro Karapataqi dhe Zaim Avazi që lexuesi ii asaj kohe nuk e ka vështirë ti personalizojë. Ata pasi informoheshin se këtë apo atë vepër e kanë pëlqyer apo është kritikuar nga funksionarë të lartë të partisë dhe shtetit, qëndisnin shkrimet e tyre sipas një kritike nihiliste apo entuziaziste.

Romani vë në lojë, qesh, përqesh, ironizon dhe stigmatizon me art, nëpunësin pa peshë të madhe në jetën politike të vendit, por nuk synon të godasë as partinë, as burrokratët e mëdhenj në sferat e larta, as sistemin socialist të burrokratizuar, siç bëri Ismail Kadare në poemën *“Pashallarët e kuq”*.<sup>19</sup>

Ky roman është një ndër të preferuarit e mi sepse përshkruan ngjarje të vërteta të përjetuara nga njerëzit. Mbi të gjitha më pëlqen mënyra se si autori shkruan. Pjesa më interesante për mua ishin esetë që i shkruante Zyloja, të cilat ishin pjesët që më bënë më shumë për të qeshur. Të gjitha ato ishin ngjarje të vërteta mirëpo shoku Zylo u jepte ngjyrim humoristik dhe i quante ese. Padyshim ato edhe më shumë e bënë qesharake figurën e Zylos.

Mesazhi kryesor i këtij romani është lufta për të drejtat tona dhe ajo kundër atyre që i shfrytëzojnë ato. Të jemi të aftë të kundërshtojmë kur na cënohet diçka e të luftojmë për atë që vërtetë duam.<sup>20</sup>

---

<sup>19</sup> [voal.ch/shkelqimi-dhe-renia-e-shokut-zylo-dhe-alibia-e-estetit-alfred-ucit](http://voal.ch/shkelqimi-dhe-renia-e-shokut-zylo-dhe-alibia-e-estetit-alfred-ucit)

<sup>20</sup> [ese.dhe.projekte/photos/analize-shkelqimi-dhe-renia-e-shokut-zylo](http://ese.dhe.projekte/photos/analize-shkelqimi-dhe-renia-e-shokut-zylo)

## 2.5. Galeria e personazheve

Shoku Zylo është personazhi kryesor në këtë roman. Ai është drejtor i sektorit të librit në sektorin e madh të kulturës. Shoku Zylo vendoset në këtë post në fillim të librit. Që në këtë moment vemë re se ai merr në dorë frerët e punës, por gjithmonë vë në dukje mangësitë e drejtorit të mëparshëm. Ai mendon se idetë dhe puna e tij janë një vlerë e madhe për shtetin e kulturën, kur të tjerët mendojnë ndryshe, por posti e bën Zylon të pakundërshtueshëm. Ai i jep vlera të pamërituara vetes e punës së tij, mendon se hierarkia shtetërore është edhe hierarki meritash. Por Zylo ka meritat e tij, por jo në nivelin që ai i imagjinon. Veprimet që ai bën herë na bëjnë për të qeshur e herë sikur ndiejmë keqardhje për shkak të padijes së Zylos. Zyloja jeton i percepton gjërat sipas iluzioneve të tij e jo sipas fakteve e së vërtetës.

Komizmi i figurës së Zylos buron nga kontradikta themelore e karakterit të tij: ai i jep vetes të tjera vlera nga ato që i takojnë, duke menduar se hierarkësia shtetërore është edhe hierarki meritash. Shoku Zylo është një nga qindra e qindra nëpunësit e mesëm të një aparati shtetëror me shumë instrumente. Ai nuk është pa merita pune, diçka ka bërë për të mirën e saj, por këto merita në peshoren e shoqërisë kanë rëndesë shumë më të vogël se në mendjen e Zylos. Në të vërtetë Zylo Kamberi është një figurë tragjikomike. Veprimet e tij të bëjnë të qeshësh, po aq sa edhe të ndiesh keqardhje. Zyloja nuk është një burokrat potexhi, bujëmadh, i zhurmshëm. Arroganca e tij është e heshtur. Prepotenca e tij është me zë të ulët. Veprimet e tij përherë priren nga qëllime të mbara, por çojnë në gabime trashanike.<sup>21</sup>

Pra ky është Zylo, një personazh sa për të ardhur keq ashtu edhe për të qeshur i cili është rezultat i pushtetit të kohës.

---

<sup>21</sup> sq.m.wikipedia.org

Demka është një nëpunës i thjeshtë si shumë të tjerë në atë kohë. Ai është personazhi që na rrëfen ngjarjen. Demka është një letrar jo pa merita dhe kjo duket në kërkesat për shkrim e referate nga shefat e tij. Demkës të gjithë i kërkojnë studime e shkrime dhe ai pranon, por jo sepse ai do. Kjo ndodh sepse ai nuk ka fuqi të kundërshtojë. Pavarësisht se thotë se herën tjetër nuk do të përsëriste të njejtin veprim, përsëri pranon. Dhe kështu referat pas referati, ai filloi të humbte jo vetëm talentin, por edhe veten e tij. Të gjithë këto tregojnë se edhe Demka është një ndër viktimat e shumta të diktaturës e cila e pengon atë ta thotë që do e të luftojë për veten e mendimin e tij.

## KREU III

### 3.1. “Njeriu me top”

Autori e mori subjektin e romanit nga hasmëria midis fiseve Manuka dhe Mera në fshatrat Arapi i Poshtëm dhe Lishani i Poshtëm. Shënimet e një prej pjesëtarëve të familjes Mera, mbi historinë e hasmërisë ndërmjet dy fiseve shërbyen si indicie për krijimin e veprës dhe më pas të filmit, i cili e ngre gjithë fabulën e tij mbi një top të artilierisë së lehtë i gjetur pas rënies së Italisë fashiste dhe qëllimi kryesor i përdorimit të tij ishte hakmarrja ndaj shtëpisë "kundërshtare". Në film Mato Gruda jeton në hasmëri me familjen e plakut Mere Fizi. Mato ka fshehur topin e artilierisë të cilin ëndërron ta përdorë kundër Mere Fizit, madje ka marrë në shtëpi si rob edhe një italian që e thërret Agush, i cili i mëson përdorimin e topit.<sup>22</sup>

Tema e këtij romani ka të bëjë me luftën partizane. Në qendër të vëmendjes është hakmarrja e kryepersonazhit Mato Gruda, i cili është “në gjak” me fisin e Fizëve. Mato Gruda nuk i donte Fizët, veçanërisht, plakun Mere. Edhe të dhjetë stërnipërit e tij i urrente. Jeta e tyre i dukej si pus. Brenda këtij pusi, sipas Mato Grudës, zienin shumë gjëra të këqija.

Shtëpia e Fizëve me shtëpinë e Grudëve kishin rënë në hasmëri, kur Ramizi e kërkoi vajzën e tyre Dudën, por nuk ia dhanë. Atëherë ai në një natë të errët u takua me të, e mori dhe iku nga fshati Arun. Atëherë stërnipërit e plakut Mere e vranë Sulën – vëllain e Ramizit, kinse ai e ka lajmëruar Dudën të takohet me Ramizin dhe pikërisht kjo ishte e shtëna e parë në fshatin Arun.

Në përgjithësi në fshatin Arun janë vranë për dy gjëra: për gruan dhe për arën. Arën donin ta grabitnin, vriteshin. Gruan e dashuronin, vriteshin. Ara dhe gruaja ishin kthyer në legjenda në fshatin Arun. Për të dyja tregoheshin rrëfime dhe këndoheshin këngë. Shumica e këtyre rrëfimeve dhe këngëve ishin rrënqethëse, por kishte edhe gazmore. Fshati Arun ishte nga fshatrat më të çuditshëm të krahinës.

---

<sup>22</sup> [https://sq.wikipedia.org/wiki/Njeriu\\_me\\_top](https://sq.wikipedia.org/wiki/Njeriu_me_top)



Fshati Arun që shtrihej në dy faqet e një kodre, një çerek ore larg xhadesë, përbëhej prej pesë fisesh: Fizët, Shtagët, Marukët, Pinxhot dhe Grudët.

Fizët ishin përhapur në dyzet shtëpi të fshatit Arun. Fjala e tyre gjithnjë ka qenë ndier, se kanë qenë edhe në gjendje të mirë ekonomike. Por dalngadalë shumë toka të tyre i blenë Pinxhot, pasi ata grumbulluan para, duke bërë tregti, e duke punuar nëpër sharra e dërstila, ku thurej shajaku dhe velenxat. Disa nga Pinxhot bile ishin më pasanikë se i pari i Fizëve. Prandaj Adnan Pinxhoja shpesh bënte shaka me plakun Mere.

Adnan Pinxhoja ishte njeri pa cipë, njeri me një sjellje të keqe, në të cilën bashkohej fodullëku me paturpësinë dhe cinizmin. Ai nuk i besonte asgjëje në botë përveç parasë, të cilën e nxirrte nga gjithçka: nga toka dhe uji, nga druri dhe guri, nga kripa dhe sheqeri, nga gozhda dhe gjilpëra. Në fshatin Arun, në lagjen ku kishte më shumë shtëpi, ai kishte hapur një dyqan dhe shiste çdo gjë për nevojtarët. Atyre që nuk kishin para, u merrte ose bereqet, ose mbante shënim në fletoret e trasha të tij dhe kur vinte koha, ua merrte arën apo korijen. Në ato fletore ishin shënuar edhe ara e Murat Shtagës, të cilën më në fund e mori. Ai donte ta shtinte në dorë edhe Shegën, stërmbesën e plakut Mere. Duke u martuar me të, ai ëndërronte të merrte edhe pjesën më të madhe të arave të Fizëve.

Të gjithë Pinxhot përbëheshin nga pesëmbëdhjetë shtëpi. Ata shkonin mirë me Fizët, por i madhi i Fizëve, plaku Mere, i kishte zili se po bëheshin më të fuqishëm se ai.

Më të varfërit ishin Shtagët dhe Marukët. Shtagët kishin tetëmbëdhjetë shtëpi dhe Marukët njëzet e pesë. Mes tyre ka pasur një hasmëri të lashtë, që nxirrte kokën herë pas here. Por hasmëria më e madhe në fshat ishte ajo e Fizëve dhe e Shtagëve.

Sa për fisin e Grudëve, as mund të flitej. Nga Grudët kishte mbetur vetëm një shtëpi, ajo e Matos. Po të mos ishin vrarë me Fizët, tani do të numëroheshin mbi pesëmbëdhjetë shtëpi. Prandaj Mato Gruda nuk fliste me Fizët. Ai e ndiente veten më të vetmuar në Arun dhe kjo për fajin e Fizëve.

Mato Gruda shkonte mirë me Shtagët dhe Marukët. Edhe me Pinxhot nuk shkonte keq, por nuk i kishte aq të afërt, se i quante njerëz pa nder e pa besë. “Të vrasin natën e të qajnë ditën” – thoshte ai kur vinte fjala për Pinxhot.

Më i rrezikshmi nga Pinxhot ishte Adnan Pinxhoja, i cili shpesh e kishte pritur në shtëpinë e vet Tosun Baçin dhe kishte pirë e kënduar me të. Por edhe Tosunit nuk i kishte dhënë fjalën për t'i rënë pas, se ende nuk ishte bindur plotësisht.

Kështu fshati Arun, i përbërë nga pesë fise dhe nga nëntëdhjetë e nëntë shtëpi, jetonte me plot trazira në këmbë të malit Kokallë e në kodrat mbi lumin Krak.

Tregojnë se plaku Mere njëherë kishte vdekur e pastaj ishte ngjallur. Njerëzit betohen se kjo që rrëfëhet në fshatin Arun, nuk është përrallë, por e vërtetë si nata. Ai vdiq. Të afërmit e tij u mbloodhën, e qanë, e mbështollën me qefin, e vunë në tabut dhe e morën për ta shpënë në varre. Binte dëborë dhe ishte ftohtë. Në mes të rrugës që nga tabuti u dëgjua një zë. Allah belaversën!

Ata që e mbanin, kur dëgjuan zërin e të vdekurit, u llahtarisën, e lëshuan dhe ia dhanë vrapit. Vetëm xherahu i fshatit, Xheladin Durballia, që mbante një gunë të madhe, nuk lëvizti vendit. Ai ia hodhi gunën në supe dhe ashtu të mbështjellë me gunë e shpuri gjer në shtëpi. E veshi me rrobat që mbante kur ishte i gjallë, ia ndezi kandilin dhe e vuri në dyshek që të vinte në vete. Njerëzit e shtëpisë ishin zhdukur dhe kishin mbetur vetëm pleqtë e plakat, se kujtonin se gjyshi i madh ishte bërë lugat. Plakut Mere i shërbente vetëm xherah Xheladin Durballia.

Gjithë fshati Arun, e ç'mer mali i Kokallës e ç'zë lumi Krak u habitën me këtë ngjarje të padëgjuar ndonjëherë dhe thanë se tani do t'i vinte fundi botës. Pastaj njerëzit e mësuan, se plaku Mere jetonte me kandil të ndezur dhe pohuan se edhe fundi i botës nuk qenkësh gjë. Prandaj ngritën edhe një këngë që nuk dihet se kush e ka kënduar i pari. Kënga thotë:

*Ty, mor plaku Mere,  
në tabut të vunë,  
të xhumanë e zezë  
në varre të shpunë.*

*Po ti seç u ngrite,  
thirre nga tabuti,*

*gjilpëra-gjilpëra  
ç'na u bë vuxhuti.*

*Në tabut të lanë,  
këmbët dhe s'u zunë,  
Xheladin xherahu  
të futi në gunë.*

*Xheladin xherahu,  
më t'u thaftë dora,  
s'e le plakun Mere  
ta hante dëbora.*

*Xherah Xheladini,  
Xheladin xherahu,  
ç'e solle lugatin,  
më t'u thaftë krahu!<sup>23</sup>*

---

<sup>23</sup> Dritëro Agolli, *Njeriu me top*, Prishtinë, 1990, f. 34

## 3.2. Galeria e personazhëve

Mato Gruda është një fshatar i thjeshtë ‘në gjak’ me fisin e Fizëve, i cili ka rënë në qerthullin e gjakmarrjes që sillet nga njëri brez në tjetrin. Një ditë në pyll ai zbulon një top të braktisur nga ushtria e tërhequr italiane, të cilin e fsheh në plevicë, me idenë e hakmarrjes ngulur në kokë. Konflikti personal me Fizët dhe me patriarkun e tyre, plakun Mere, e bën të mos shohë dasinë politike të thellë në fshat, të shkaktuar nga prania e lëvizjeve rivale të rezistencës dhe nevojën e ngutshme të partizanëve në luftën e tyre kundër pushtuesve gjermanë. I zhgënjyer nga padija e vet dhe nga dështimi në goditjen me top të shtëpisë së Fizëve, si dhe helm e vrer nga vrasja e shokut të tij Murat Shtaga, Mato Gruda arrin të kuptojë se interesa më të lartë janë vënë në rrezik, prandaj dhe e tërheq topin e tij të vetëm zvarrë për t’u ardhur në ndihmë aleatëve të tij partizanë, që u kishin zënë pritë gjermanëve.<sup>24</sup>

Murat Shtaga ishte miku i ngushtë i Mato Grudës. Ai ishte njeri i urtë e zemërbardhë. Ishte ortak i mirë me Mato Grudën dhe asnjëherë nuk kishin këmbyer ndonjë fjalë të keqe. Murat Shtaga gjithashtu ishte në hasmëri me fisin e Fizëve.

Zara ishte gruaja e Mato Grudës. Ishte një grua e hollë dhe e bukur. Zara nuk i ngjante s’ëmës. Zara trembej nga një top i heshtur. Zara nuk i sheh dot armët, kurse e ëma e saj ka shtënë me armë dhe u ka zënë pritë hasmëve dhe, po të gjente një top edhe me atë do të qëllonte. Zara kishte një shpirt të butë dhe të brishtë. Ajo kishte lindur dy djem Zigurin dhe Sadikun. Ishte një grua shembull që çdo femër do ta lakmonte.

Esmë ishte halla e Mato Grudës. Ajo ishte një grua plakë e shtyrë në moshë. Ajo kishte leshra të gjatë dhe vazhdimisht qëndronte me cigare në gojë. Ishte e sëmurë dhe gjatë gjithë kohës qëndronte e shtrirë në shtrat.

---

<sup>24</sup> Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Pejë, 2001, f. 407

### 3.3. “Dështaku”

Romani “*Dështaku*” është një ndër romanet më të rëndësishme të Dritëro Agollit. Është i ndarë në gjashtë pjesë të cilat përbëjnë një vazhdimësi të vetme. Fillon me përshkrimin e ecjeve nëpër baltë të dy personazhëve që nuk i njohim, të cilët ecnin me vështirësi nëpër baltë por që nuk e kuptojnë se kush ishin dhe pse ishin së bashku. Në bisedë e sipër shohin që ishin dy dashnorë të fshehtë të cilët nuk do të duhej t’i shihnin së bashku por ja që dashuria i bashkon. Ishte ky Xhelo Mara i cili kishte ardhur nga një fshat tjetër në fshatin Kallamagjatë dhe kishte marrë postin e kryetarit të kooperativës, post ky që më parë i kishte takuar Feti Kalasë, por që tani ai ishte kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit.

Në këtë kapitull të parë më së shumti autori na njeh me natyrën e fshatit, fshat ky me shtëpi të rradhitura në fundin e faqes së saj në tri harqe, si në një amfiteatër të madh. Në mes të këtij amfiteatri, nën rradhën e poshtme të shtëpive ishte qendra e fshatit me zyrat e saj. Edhe kjo qendër nga larg i shembëllente podiumit të amfiteatrit.<sup>25</sup>Përveç natyrës me tërë ngjyrat e saj e shohim të vihet në pah edhe dashuria e Xhelos me Hatixhen. Xhelo ishte i martuar dhe kishte një grua të bukur, megjithatë ai me të ardhur në fshat dashurohet tek Hatixhja, një vajzë fshatare e cila ishte e vetme me nënën e paralizuar në shtrat. Ajo e bëri për vete Xhelon me bukurinë, thjeshtësinë dhe ngrohtësinë e saj të cilën e kishte shfaqur ndaj Xhelos që kur ai kishte ardhur në fshat. Ajo i dërgonte ushqimin dhe i jepte prehjen e një gruaje sa herë që ai ndjente nevojën. Gjithashtu shohim teksa autori bën përshkrimin e punës së fshatarëve në kooperativë, shohim të hyrat e Xhelos nëpër shtëpi në mënyrë agresive, për t’i urdhëruar të dalin në punë e duke i sharë e duke i ofenduar. Kur ishte fjala për në punë ai nuk e kursente as Hatixhen të cilën e donte aq shumë. Këtë më së miri e shohim tek e përshkruan autori në roman.

Xheloja çdo gjë mund ta harojë, kur vjen puna për të komanduar njerëzit dhe për t’i hedhur në ndonjë sulm a në ndonjë betejë, mendonte ajo dhe e ndiente veten të huaj

<sup>25</sup> Dritëro Agolli, *Dështaku*, Tiranë, 2000, f. 6

mes arës me grurë, e lagur që nga flokët e gjer te këmbët. Por në të njëjtën kohë e vështronte me kënaqësi këtë burrë të gjatë e flokëverdhtë, me xhaketë të madhe lëkure e me tri vija të thella në ballin e gjerë.<sup>26</sup> Këtë pra më së miri e shohim përmes përshtypjeve të Hatixhes për Xhelon, ku shihet qartë që Hatixhja ishte e vetëdijshme se Xhelo e dashuronte, por që edhe për punë nuk do ta kursente. E këtë e vërteton edhe vetë ai në rreshtat në vijim: “Ç’ më vështroni? Prisni fjalime nga unë? Nisuni dhe mblidhni gjithë fshatin me kuçe e mace! – pastaj iu kthye Hatixhesë: - Po ti ç’pret? Shko dhe nxirri nga strofkat ato shoqet e tua, që qëndisnin me grep! T’i lënë grepat! Marsh!- dhe vetë ktheu shpinën e gjerë dhe u nis drejt fshatit me belin e Hatixhesë në sup.”<sup>27</sup>

Ky ishte Xhelo gjatë ditës në punë, i bujshëm, i rreptë, kërkues. Kurse gjatë natës e shohim tek kërkon prehje tek e dashura e tij Hatixheja, e cila e kishte shumë të vështirë t’i shkonte për qejfi Xhelos, sepse e kishte nënën e lidhur për shtrati dhe i vinte keq ta linte të vetme, mirëpo dashuria ndaj tij gjithonë e bënte të gjejë një mënyrë dhe t’i falë ngrohtësinë atij dhe gjithashtu të kënaqë edhe veten e saj.”Pas tri-katër ditësh Xhelo Marën e thirrën me shpejtësi, sikur në zyrat e tij të kishte rënë zjarri. E kërkonte Feti Kalaja, kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit, që kishte ardhur nga qyteti vetë i dytë.”<sup>28</sup>

Shoqëruesi me të cilin priste Feti Kalaja para zyrave ishte Abedin Shpuza si dhe Petrika Kaleshi të cilin Xhelo e njihnte prej kohësh, që në Korçë, madje kishin qenë të dy në një shkollë dhe i cili kishte ardhur ngase do të punonte në komitet. Sidoqoftë, Xhelo Mara nuk e kishte idenë se ç’mund të ishte arsyeja që e thirrën aq me ngutë. Ai i ftoi në zyrë dhe aty filloi biseda. U ulën në tryezë dhe filluan të flasin fjalë të përgjithshme, për kohën, mbjelljet, fshatin, lumin. Më pas e pyetën për pjesëmarrjen e gruas në punë, e Xhelo u prek në damar. Mirëpo, duke ruajtur gjakftohtësinë ai u arsyetua se vajzat dhe nuset nuk dalin të gjitha në fushë, por duke u dhënë edhe pak të drejtë sepse koha ka qenë e ftohë dhe ka pasur shira. Megjithatë, Feti Kalaja i cili ishte i njohur për faktin që Xhelo mbante lidhje dashurie me njërën nga vajzat e fshatit, vazhdoi ta provokonte duke i thënë, a thua vetëm koha dhe shirat janë arsyeja që ato nuk dalin. Më pas duke mos përfillur

---

<sup>26</sup> Dritëro Agolli, *Dështaku*, Tiranë, 2000, f. 25, 26

<sup>27</sup> Dritëro Agolli, *Dështaku*, Tiranë, 2000, f. 26

<sup>28</sup> Dritëro Agolli, *Dështaku*, Tiranë, 2000, f. 41

fjalët e Xhelos i tha atij se ishte bërë shembull i keq në fshat, i tha se ishte vetë fajtorë për mosdaljen e gruan në fushë, gjithashtu duhet të ndërpriste lidhjen me Hatixhen dhe të sillte gruan e tij në fshat, sepse kjo çështje ishte e ndjeshme për fshatin dhe se gratë nuk dilnin në punë në shenjë proteste ndaj sjelljes së tij. Gjithashtu diskutuan dhe e akuzuan për shpërndarjen e bagëtive që kishte bërë Xhelo nëpër shtëpitë e fshatarëve, e akuzuan se kishte shkatëruar kooperativën, kurse ai arsyetohej se po të mos kishte marrë një veprim të tillë, të gjitha kafshët do të kishin ngordhur nga moti i keq, pra nga lumi që kishte dalë nga shtrati.

Pas një jave Xhelon e thirrën për të shkuar tek Komiteti Ekzekutiv. E kishte thirrur Feti Kalaja, por tani jo për çështjen e Hatixhes, por për kooperativën të cilën e kishte shpërndarë, sepse sipas tij kooperativa kishte një parim që sduhej thyer, sipas tij më mirë të ngordhte e gjithë bagëtia se sa t'u ktheheshin fshatarëve. Kurse Xhelo, duke qenë njeri me shpirt human, kishte bërë të kundërtën, ai kishte shpërndarë kafshët derisa të ndërtoheshin shtallat me qëllim që bagëtija mos ngordhte. Mirëpo, sido që të ishte mendimi i Xhelos, sado human, sado pozitiv, fshati dhe komiteti nuk mendonte njejtë si Xhelo, andaj edhe e kishin thirrur për t'i kumtuar se në vend të tij do të vihej Petrika Kaleshi, shoku i shkollës së Xhelos nga Korça.

Pas tri-katër ditësh stallat u ngritën dhe gjithashtu u bënë grazhde të gjata, të ndara për çdo lopë e ka dhe kolibe të vogla për viçat. Me t'u mbaruar e gjithë kjo punë u bë edhe shpërndarja e bagëtive, por tani nga shtëpitë e pronarëve nëpër stallat e reja, duke mos lënë anash edhe pengesat që hasi Xhelo me inatet e fshatarëve, disa nga të cilët tani më nuk pranonin që t'i kthejnë mbrapsht bagëtinë, siç ishte Bamja dhe plaka Nafije. Sikur të mos mjaftonte e gjithë kjo, tani Xhelos i'u desh të merrej edhe me gruan e tij e cila papritur kishte mbërritur në fshat. Vizita e saj e tronditi tej mase Xhelon e gjorë. Ajo i foli atij, shfaqti pakënaqësitë e saja si grua, sidomos ndaj fëmijëve, foli me kode duke i bërë të ditur kështu që ishte në dijeni për gjithçka, gjë që kjo qetësi e saj e bëri që Xhelo t'i shprehte dëshirën për divorc, gjë që ajo e pranoi me shumë lehtësi, duke mos e shkelur krenarinë me të cilën ajo karakterizohej si grua.

Pas një kohe Xhelon e thërrasin për ta marrë në pyetje dhe për t'i kumtuar se tani në Kallamagjatë si kryetar vjen shoku Anton Dule, kurse Xhelon e kishin caktuar si nënkryetar në Dëllinjas. E gjithë kjo që ndodhte ishte për shkak të shpërndarjes së

bagëtime, vonesës së të mbjellave dhe dashurisë me Hatixhen. Tani kryetar Komiteti ishte vënë Petrika Kaleshi, shoku i shkollës së tij. Përveç që u mor në pyetje në lidhje me shpërndarjen e kooperativës atij iu kërkua në mënyrë të dhunshme të shkruajë biografinë e tij të detajuar. Për ta shkruar atë e mbyllën në një zyrë të errët pa bukë e ujë. Nga shkrimet e tij morëm vesh që Xhelo kishte lindur shtatë muajsh dhe që atëherë e kishte marrë nofkën e dështakut. Por i mbeti emri i tillë ngase gjithashtu ia kishin vonuar tre muaj vënien e emrit, liceu që kishte filluar i kishte ngelur përgjysmë dhe shumë ndodhi të tjera bënë që ai të merrte nofkën “Dështaku”. Gjithë këtë përshkrim biografie Xhelo e kishte nga Pandi Këmbora, kunati i tij dhe Dalip Kozara që i thurrnin të paqena duke qenë kinse besnik të një misioni të çuditshëm, të pakuptueshëm e të errët.

Pasi mbaroi këtë punë Xhelos tani i'u desh ta dorëzonte fronin Anton Dules, të cilit ia tregoi të gjitha punët se si shkonin, çka kishte bërë ai, çka kishte arritur të bëjë dhe çka mendonte se duhej bërë. Duke i folur në këtë mënyrë të singertë, Anton Dule ndjeu keqardhje për Xhelon, madje i tha që në komitet kishte thënë se ishte i gabuar vendimi për të ardhur ai në vend të Xhelos. Sidoqoftë, mbaroi edhe këtë punë dhe tani i'u desh të nisej për në Korçë për t'u takuar me Marikën, me të cilën duhej të bisedonte rreth divorcit të tyre, gjë që edhe ndodhi me lehtësi, pasi Marika nuk e kundërshtoi aspak.

Pas një kohe Xhelo shkon në Dëllinjas ku edhe i ishte caktuar posti i nënkryetarit, kurse kryetar ishte Nexhmedin Gyzeli. U njoftua me të dhe kuptoi që ishte një burrë i mirë dhe nga ai gjeti një mikpritje që askush nuk ia kishte dhënë në fshatin Kallamagjatë. Ai shprehu dëshirën dhe gatishmërinë që Xhelos t'i ndërtojnë edhe një shtëpi ku ai do të jetonte me Hatixhen, të cilës i kishte dalë nami se ishte me barrë, situatë kjo që e detyroi Xhelon të shkojë deri në Kallamagjatë dhe të martohet me të për t'ua mbyllur gojën fshatarëve.

Pas një kohe fshatin Dëllinjë e vizitoi Petrika Kaleshi. Ai me një fjalë kishte ardhur më së shumti për ta provokuar Xhelon dhe për ta dëmtuar atë se sa për të kontrolluar punët e fshatit. Kjo që i frikësoheshin edhe ndodhi. Erdhi urdhëri që Xhelo Mara duhej të shkarkohej edhe nga posti i nënkryetarit pasi kishte fyer dhe kundërshtuar Petrika Kaleshin. Ai tani do të duhej të punojë tokën si një fshatar i thjeshtë. Ky vendim kishte ardhur nga Tirana, nga shkoku Z, i cili e kishte thirrur Nexhmedin Gyzelin për t'ia kumtuar, të cilin lajm Xhelo e priti në mënyrë normale. Sidoqoftë shtëpia në Dëllinjas u



ngrit. Arkitekt dhe investitor për të kishte qenë vetë Nexhmedin Gyzeli, i cili e vlerësonte shumë Xhelon dhe e donte afër vetes. Tani ishin të nevojshme vetëm gjërat me të cilat do vishej shtëpia nga brenda, të cilat Xhelo doli një ditë dhe i bleu. Më pas u nis për në fshatin Kallamagjatë për të marrë Hatixhen dhe nënën e saj të sëmurë. Për t'i çuar në shtëpi të re, atij i'u desh një qerre ku do ta shtrinte plakën e gjorë, e cila asesi nuk donte të largohet nga vatra e saj. Tek po ecte qerrja e rënduar nga balta, plaka rënkonte dhe kërkonte që ta kthenin që të vdiste e qetë në shtëpinë e saj. Mirëpo, kthimi i kësaj qerreje ishte fatzi dhe fatal për Xhelon të cilin e vranë dy njerëz sa të panjohur po aq edhe të njohur.

## KREU IV

### 4.1. “Arka e djallit”

“*Arka e djallit*” është një libër i lehtë për t’u lexuar, por shumë i vështirë për t’u analizuar. Dritëro Agolli nisi ta shkruajë “*Arkën e djallit*” në fillim të viteve 1980 kur letërsia shqipe i hidhte me shumë kujdes hapat e vet, duke njohur rreptësinë e metodës dhe vështirësitë “për t’ia hedhur” asaj. Romani u përfundua në fillim të viteve 1990, kur në jetën shqiptare hyri një kuptim tjetër i lirisë së mendimit dhe të krijimit.

Në romanin “*Arka e djallit*” lexuesi gjen disa shkallë të lirisë.

Shkalla e parë e lirisë së shfaqur është ajo e shkrimtarit. Dritëro Agolli edhe herë të tjera ka treguar se di të rrezikojë në letërsi. Romani “*Arka e djallit*” ka në qendër të veprimit një shkrimtar: Sherif Abecenë. Detyra e tij është të zbulojë “arkën e djallit”, një sënduk ku ruhen dorëshkrimet e ndaluara të një autori që “ka shkelur vijën”. “Djalli” që duhet të zbulojë shkrimtari, s’ka të bëjë me demonologjinë popullore, as me ndonjë qenie që tundon njeriun për të dale nga rruga e perëndisë. “Djalli” është romani “*Shakaja e ndaluar ose njeriu që e ndaluan të qeshë*”, një vepër e ndaluar e shkrimtarit të dënuar Bamkë Dynjaja, jeta e të cilit është e ndërlikuar në episode të paqarta, që mbeten enigmatike deri në fund dhe që lexuesi duhet t’i marrë me mend si shprehje desidence.

Shkrimtari Dritëro Agolli, duke vendosur në qendër të romanit të tij kërkimin për të zbuluar një tabu, duke kërkuar të ndaluarën, shfaqet me një përmasë lirie që gjendet mbi lirinë e shoqërisë, mbi lirinë shtetërore, mbi lirinë e qytetarëve të zakonshëm, mbi lirinë që ofronte metoda. Në një farë mënyre, shkrimtari me këtë zgjedhje merr vendimin “të ulet në karrigen e djallit” dhe të bëhet avokat i tij, të marrë në mbrojtje sëndëkun e drunjtë ku është ndryrë mendja dhe krijimtaria e një shkrimtari që kërkonte ndryshime në shoqëri.

Shkalla e dytë e lirisë shprehet nga shkrimtari Sherif Abeceja, i cili, si personazh i librit, ndërmerr udhëtimin për në fshatin e largët Qershizë, me qëllim që ta shpëtojë “*arkën e djallit*”, romanin e ndaluar të Bamkës.

Një shkallë e tretë e lirisë krijuese gjendet në “shthurjen” e Cute Babules, një personazh që gjithashtu shumë herë bëhet bartës i mendimeve të autorit, sidomos në filozofinë e tij për jetën, për njeriun dhe botën, për atdheun dhe planetin, për historinë dhe të sotmen, për popullin dhe qeveritë. Cute Babulja, në romanin “*Arka e djallit*”, qysh në fillim të viteve 1980 protestonte kundër lënies së fshatarit pa bagëti, pa një cope pronë të vogël. Cute Babulja është paraqitur në vepër si njëfarë “sherr-budallai”, që përpiket t’i bëjë të pranueshme idetë e tij duke i fshehur pas një shakaje, pas një sofizmi, pas një naiviteti. Ai ka arritur fitoren e madhe që edhe “atje lart” të mendojnë e të thonë: “Kështu e ka Cutja!”. Ai është i lirë të pohojë mendime që as shkrimtarit me fame botërore Sherif Abeceja nuk i shkon në mendje t’i shprehë.

Nuk është e rastit që Dritëro Agolli, duke e quajtur romanin e tij “*Arka e djallit*”, që nënkupton sëndukun ku mbahet e kyçur vepra e ndaluar e Bamkë Dynjasë, i ka paralajmëruar një fund të trishtuar atij.

**Në romanin “*Arka e djallit*”** Dritëro Agolli ka mundur të realizojë një performance shumëzërëshe të ideve dhe meditimeve të tij. Ai flet me ndërgjegjen e tij. Kjo është një vepër ku nuk ka pengje. Një nga shprehjet më të rëndësishme të pjekurisë së lirisë krijuese është të fitosh mbi kufizimet e vetvetes.

Një nga dukuritë më interesante që vihen re në romanin “*Arka e djallit*” është mjegullimi me marifet i qëndrimit emocional të autorit, shprehja e vetvetes në një shumësi emrash. Filozofia dhe konceptet e shkrimtarit gjenden, në aparençë, më shumë tek figura e Sherif Abecesë, por befasi ato dalin të shtjelluara në një formë shumë të qartë në arsyetimet e Cute Babules, në realizimin e ashpër të Bamkë Dynjasë, në figura të tjera të rendit të dytë.

Autori i veprës shihet i projektuar në figurën e shkrimtarit Sherif Abeceja në sjelljet e tij të sërta, në tiparin e tij të këmbënguljes për të zbuluar atë që të tjerët përpiqen ta mbulojnë, në heshtjen dhe dialogjet “me popullin”. Ai shihet i projektuar tek figura e Cute Babules në mënyrën si ndërton humorin, si u heq cipën mashtrimeve, si sillet shpenguar në marrëdhëniet me të huajt, si mund komplekset e veta dhe gjen shtigje e rrugëdalje edhe në situata të vështira, si i ndërton bisedat dhe lidhjet me fshatin dhe fshatarët, si preket e ligështohet pas gabimeve dhe qortimeve.

Në figurën e Bamkë Dynjasë është një pjesë e fatit real të vetë shkrimtarit. Është fakt se Dritëro Agolli pati nisur ta botonte *“Arkën e djallit”* në formën e fragmenteve, por fundi i saj që ndalimi, një sënduk njësoj si ai i *“Shakasë së ndaluar”* të Bamkës.

Një nga vlerat më të rëndësishme të romanit *“Arka e djallit”* është hapja e autorit ndaj botës kulturore të Orientit. Kjo është një përpjekje për të zbuluar disa të vërteta të thjeshta, që kanë të bëjnë me kuptimin e universit njerëzor në tërësinë dhe ekuilibret e tij. Dritëro Agolli, përmes *“Arkës së djallit”*, e dëshmon veten një njohës të shkëlqyer të kulturave tradicionale të popujve të Lindjes muslimane, të letërsisë së tyre të mirënjohur, të riteve dhe zakoneve të jetesës, të ngjashmërive dhe ndryshimeve kulturore me ato të

popullit të tij. *“Arka e djallit”* i sjell lexuesit pamje të mahnitshme të një bote që hera-herës padrejtësisht është parë me nënçmim. Autori ia arrin t’i imponojë respekt lexuesit për vlerat e kësaj bote, e cila jo vetëm që s’ka asgjë mangut metropoleve perëndimore, por në shumë pikëpamje, është konkurrenente dinjitoze e tyre.

Qëllimi i shkrimtarit për të ndikuar në opinionet letrare për një ekuilibër të vërtetë vlerash shihet jo vetëm në admirimin e vlerave kulturore lindore, në madhështimin e figurave të ndritura të këtyre kulturave, si Xhelaledin Rumi, por dhe në formën stilistikore si e ndërton frazën. Ja një paragraf tipik, ku qoftë edhe vetëm përmes stilit, ndikohet për të përfytyruar botën si një të tërë: *“Një fenomen i tillë, që të hynte në vallen e dervishëve një i jashtëm, qoftë turk e qoftë kaur, ka 722 vjet që nuk është përsëritur që kur ishte gjallë hazreti Mevlana Muhamed Xhelaledin Rumi. Kur jetonte hazreti, në një ceremoni dervishësh, u fut papritur mes valles një sarhosh dhe filloi të kërcëjë. Në kërcim e sipër i shtynte me bërryl dervishët, duke ua penguar rrotullimin. Atëherë semazeni e shau sarhoshin dhe iu ankua hazretit Mevlana: “Ky është i pirë dhe duhet ta përzëmë nga vallja!”. Dhe hazreti Mevlana Muhamed Xhelaledin Rumi iu përgjigj: “Ai ka pirë hyjninë, ju po silleni me të si një pijanec!” Kjo frazë, që ka mbetur sii ese, në frëngjisht shprehet: “Lui, il a bu divin, vous agissez en ivrogne”.*<sup>29</sup>

Ngjarjet në roman shkojnë, sipas një logjike të pamëshirshme, drejt zhdukjes së këtij sënduku, që është sinonim i arkivit. *“Arka e djallit”* është një libër që përpiqet ta kapë historinë sa pa u larguar e pa u vështirësuar edhe më mbërritja tek e vërteta.

---

<sup>29</sup> Shaban Sinani, *Njeriu dhe dukuria atipike në veprën e Dritëro Agollit*, 2006, f. 291

## 4.2. “Trëndafili në gotë”

Romani “*Trëndafili në gotë*” (1980) u prit nga mendimi letrar si një “libër rozë”, por me këtë vepër Dritëro Agolli provoi të bënte një sfidë tjetër në letërsi, duke krijuar një vepër me një personazh që gjendet midis dashurish, pa tema epokale, pa epizëm dhe heroizëm.

Në këtë vepër autori i tërhiqet sadopak ngjarjeve të luftës. Në qendër të veprës është personazhi Minai, njeri i humbur nga realiteti i kohës, i zhytur në vetmi, mirëpo njeri i cili vëzhgon gjithçka rreth vetes. Ishte njeri i përpiktë, i cili kishte ardhur të jetonte në një qytezë të vogël se kishte marrë leje për të shkruar një libër me tregime. Ai ishte vendosur në një dhomë në hotelin e qytezës dhe çdo ditë gjer natën vonë shkruante. Drekën dhe darkën i hante në restorant, në katin e parë të hotelit, kurse mëngjesin zakonisht në dhomë. Të gjithë banorët e qytezës e njihnin, kurse me njerëzit që shërbenin në hotel e restorant ishte bërë si i shtëpisë. Në restorant kishte tavolinën e tij, ku nuk ulej asnjëri. Kamarieria që shërbente në restorant ishte një vajzë e re me sy të kaltër dhe me një gërshet të gjatë. Ajo çdo ditë e shërbente Minain.

### 4.3. Përfundimi

Në përfundim të këtij projekti unë mësova mbi letërsinë bashkëkohore, vështirësitë dhe peripecitë që kanë kaluar shkrimtarët e asaj kohe. Tema mbizotëruese e letërsisë së këtyre viteve ishte liria e fituar nga Lufta nacionalçlirimtare. Gjuha e rrëfimit letrar dhe protagonist ishin karakteristikë e veprave letrare të kësaj periudhe. Disa nga shkrimtarët e periudhës bashkëkohore janë Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Petro Marko, Fatos Arapi, me veprat e rëndësishme si: *“Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur”*, *“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”*, *“Shpella e Piratëve”*, *“Gjeniu pa kokë”*.

## **Deklarata e autorësisë**

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se kjo tezë e magistraturës përfaqëson punën time origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë, nuk kam përdorur burime të tjera, përbeç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve. Studimi i kësaj teme është shkruar prej meje, nuk është prezentuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose në pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

## V ë r t e t i m

Kandidatja **Mamudije Muaremi** dorëzoi për redaktim gjuhësor temën e saj të magistraturës me titull: **Struktura narrative dhe galeria e personazhëve në prozën e Dritëro Agollit**. Tema e saj iu nënshtrua shqyrtimit dhe redaktimit të përgjithshëm gjuhësor. Andaj kam bindjen se ky studim letrar është në përputhje të plotë me kriteret gjuhësore dhe standardin drejtshkrimor të gjuhës shqipe.

Profesor Thimi Nesti



